

GËZIM TUSHI
EDUKIMI NË FAMILJE DHE NË SHKOLLË
Kontekste të reja të marrëdhënieve
PRIND-MËSUES-NXËNËS

BOTIMET TOENA

GËZIM TUSHI

EDUKIMI NË FAMILJE
DHE NË SHKOLLË

Kontekste të reja të marrëdhënieve
PRIND-MËSUES-NXËNËS

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2017

Mirënjohje të thellë zotit Ilir Adili,
me kompaninë AK,
që pa ngurrim mbështetën botimin e këtij libri.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Besa Vila
Korrektore: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike: Elida Stafa
Kopertina: Ana Shema

ISBN 978-9928-235-39-8

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

KAPITULLI I PARË

EDUKATA DHE KRIZA E EDUKIMIT

Autoriteti dhe kriza e edukatës paternaliste

Kriza e paternalizmit si filozofi e diktimit subjektiv, e drejtimit dhe e komandimit arbitrar të jetës së adoleshentëve dhe të rinjve në familje dhe në shkollë ka filluar të bëhet një problem social i mprehtë. Ai është një realitet i përgjithshëm social që shfaqet me virulencë të dukshme në të gjitha “institucionet e disiplinës” (familja, shkolla, institucionet fetare). Ne kemi hyrë pa kthim në epokën e shoqërisë së lirë që ka ndikimet e veta në strukturën dhe funksionimin e familjes, shkollës dhe shoqërisë. Ato janë në ndryshim të shpejtë jo vetëm si struktura funksionuese, por dhe i raporteve klasike të vartësisë materiale, edukative dhe të të gjithë parametrave të autoritetit paternalist të prindërve dhe mësuesve mbi adoleshentët.

Kjo dukuri masive ka sjellë shumë keqkuptime edukative dhe sociale në shoqërinë e ditëve tona, në familje dhe në shkollë, qoftë si krizë e autoritetit të prindërve, kryesisht të babait në familje (për shkak të natyrës patriarkale të familjes), të mësuesit që nuk kupton se nuk është në shkollën e dikurshme paternaliste, ose si tregues i dobësimit të autoritetit të shtetit në shoqërinë demokratike.

Zgjerimi i lirisë, pavarësisë relative të adoleshentëve dhe të rinjve nga institucionet sociale dhe edukative klasike të shoqërisë, ka krijuar idenë të një pjesë prej tyre, se liria personale është e kundërta e disiplinës, respektit, moralit, edukatës dhe diktimit të normave me natyrë paternaliste. Në të vërtetë nuk mund të mohohet se zgjerimi i dimensionit të lirisë personale, i parimeve të liberalizmit në familje, në shkollë dhe përgjithësisht në të gjithë shoqërinë shqiptare të ditëve tona, është në thelb një goditje e dimensionit të vjetër të ushqyer nga mentaliteti paternalist, që ka në bazë autoritetin e ekzagjeruar të institucioneve sociale bazë të shoqërisë si familja dhe shkolla mbi adoleshentët dhe të rinjtë.

Në mënyrë të veçantë kjo situatë konfliktuale është shfaqur dukshëm në streset që po përjeton familja dhe shkolla shqiptare në marrëdhëniet e vështira midis prindërve, mësuesve dhe adoleshentëve. Kriza e dimensionit të vjetër paternalist të autoritetit të prindërve në familje dhe mësuesit në shkollë është një nga temat e mëdha të sociologjisë, pedagogjisë dhe politologjisë moderne. Nga pikëpamja sociologjike situata në familje, në shkollë dhe në shoqërinë shqiptare është e tillë që na detyron të gjejmë zgjidhjet e duhura normale, humane, edukative duke bërë ridimensionimin e roleve, duke shmangur atë plagë për të cilën ankohen shumica e prindërve dhe mësuesve dhe që në thelb ka të bëjë me “krizën e autoritetit” prindëror dhe pedagogjik në marrëdhëniet me adoleshentët dhe të rinjtë.

Autoriteti mekanik i babait, i nënës, i më të rriturit në familje, i mësuesit në shkollë, i klerikut në institucionin fetar, ka filluar të humbasë idolatrinë e dikurshme mbi adoleshentët dhe të rinjtë. Ato kanë filluar të lëkunden nga zgjerimi i

dimensionit të lirisë për të rinjtë në familje dhe në shkollë, i shoqëruar nga efektet e shekullarizimit të shoqërisë, zgjerimit të përmasave të demokracisë në shoqërinë tonë të re.

Kriza e identitetit të autoritetit në “institucionet e disiplinës”, sidomos në familje dhe në shkollë duhet kuptuar dhe interpretuar drejt, sepse në shumë raste konceptet e gabuara janë bërë shkak që po sjellin destabilitet, anarki, mungesë mirëkuptimi, ngatërrim rolesh, konflikte sociale midis atyre që kanë role sociale dhe edukative nga njëra anë dhe të rinjve nga ana tjetër. Madje për fat të keq, në shumë raste të shoqëruara edhe me pasoja tragjike. Realitetet e reja, që zhvillohen në këto marrëdhënie, duhen kuptuar drejt.

Kriza e autoritetit në familje dhe në shkollë është më shumë e lidhur më mënyrën dhe paradigmat e vjetra të autoritetit paternalist të prindërve, kryesisht të babait, i cili në familjen tonë patriarkale ka qenë i padiskutueshëm mbi adoleshentët. Po kështu edhe autoriteti i mësuesit në “shkollën e vjetër”. Që të funksionojë autoriteti në çdo institucion të disiplinës sociale, më së pari ata që luajnë “role disiplinore dhe edukative”, që kanë përgjegjësi, duhet të kuptojnë kohën, imperativët e saj, zgjerimin e të drejtave dhe lirive të pjesëtarëve të tjerë që bashkëjetojnë në institucione të tilla siç është familja dhe shkolla.

Në mendimin sociologjik dhe pedagogjik të kohës sonë ka shumë analiza sociologjike, për ridimensionimin e funksionit edukativ të familjes dhe të shkollës, për rolin e autoritetit në përgjithësi dhe atij prindëror dhe pedagogjik në shoqërinë postmoderne.

Filozofi i shquar gjermano-amerikan, Herbert Marcuze, njohës i shkëlqyer i shoqërisë moderne dhe i institucioneve të

saj, tregon shkaqet përse në kohën tonë ndihet thellë "... rënia e funksionit shoqëror të familjes". Sipas tij "në të kaluarën ishte familja ajo që mirë apo keq, rriste dhe edukonte individin duke transmetuar tek ai edukatë, rregulla morale dhe vlera sociale të përbashkëta". Por tani familja është nën ndikimin e faktorëve të fuqishëm ekstrasfamiljarë. Ajo është një institucion që po demokratizohet në tërë strukturën dhe funksionet e saj. Rolet e dikurshme, raportet fikse të autoritetit "pa kusht" të prindit mbi adoleshentët dhe të rinjtë kanë pësuar ndryshime dhe ristrukturime të ndjeshme. Situata e autoritetit në familjen shqiptare nuk është më ajo që ka qenë më parë.

Në këtë proces ndryshimi, ridimensionimi dhe përmirësimi të raporteve dimensionale të autoritetit midis pjesëtarëve të familjes, kanë ndikuar shumë faktorë ekonomikë, politikë, socialë dhe kulturorë. Nëse më parë familja ka qenë strukturë themelore, që udhëhiqte procesin e përshtatjes së njeriut në shoqëri, tani gjërat kanë ndryshuar. Fjala vjen, duke parë realitetin tonë, është fare e qartë që roli i familjes shqiptare në këtë aspekt është zbehur. Filozofi i Shkollës së Frankfurtit, Max Horkheimer, duke bërë anatominë e familjes moderne zbulon dialektikën e autoritetit. Sipas tij në shoqërinë moderne "kushdo është nën kamxhikun e një instance eprorë. Ata që zotërojnë majat e komandimit kanë vetëm pak përparësi në autonomi, në dallim nga vartësit e tyre; ata shtypen nga pushteti që ushtrojnë".

Në kohën tonë është e vështirë që me adoleshentët të aplikohen modelet e vjetra të autoritetit paternalist, qoftë në familje ose në shkollë. Aq-aq më tepër është e vështirë kur ajo shfaqet si "dhunë shpirtërore" me natyrë diktuese a imponuese. Paternalizmi edukativ është imponimi që i bën

adoleshentët dhe të rinjtë qenie me defekte, qytetarë me aftësi të kufizuara për integrimin e tyre social. Pikërisht edukata e “fortë”, e ngurtë, paternaliste bëhet shkak që adoleshentët të shfaqin paaftësi përballë jetës dhe sfidave të saj.

Në këtë aspekt, padituria e disa prindërve dhe mësuesve nuk është më argument për të besuar në vlerën e edukatës së fortë, disiplinës me natyrë autoritariste dhe kërkesave me tendencë paternaliste, që pengon rritjen, zhvillimin harmonik normal të personalitetit të adoleshentëve dhe të rinjve, pikërisht në familjen dhe shkollën e tyre, në këto institucione të rëndësishme të organizimit të jetës sociale, të cilat duhet t’i shërbejnë edukimit, të garantojë rritjen normale dhe sigurinë morale.

Ata janë qenie të reja sociale të cilët nuk mund të edukohen dhe nuk kanë nevojë për të ushtruar dhunë dhe edukatë paternaliste. Rregullat e jetës sociale dhe postulatet edukative të qytetërimit adoleshenti i mëson edhe në familje, jo me dhunë verbale, fizike apo psikologjike por në mënyrë të natyrshme dhe me mjete organike. Për këto arsye pesha e tepërt, e panevojshme e autoritetit të prindërve, jep kundërefekte negative edukative, duke kultivuar tek ata shpirtin e flashkur konformist, mungesën e iniciativës, frikën e përherëshme ndaj autoritetit paternalist, që më pas i shfaqet si tipar defektoz i personalitetit, pikërisht në momentin kur ata kalojnë në jetën personale e të pavarur nga familja e tyre.

Dhuna e paternalizmi nuk e lë adoleshentin të rritet, të bëhet qenie integrale autonome, e zhvilluar dhe me personalitet të plotë. Paternalizmi i deformon ata dhe i bën thjesht “bebe të rritura” që për të ecur duan vazhdimisht këshilla, urdhra për çdo veprim personal në jetën e tyre. Ai bëhet i varur ndaj çdo

lloj autoriteti të ngjashëm me atë të prindërve të tij. Besoj se jemi në kohë për të bërë ndryshimet e duhura në raportet prind-fëmijë dhe në ridimensionimin e roleve edukative brenda familjes shqiptare.

Por që të bëhet kjo duhet të mësohemi së pari të pranojmë disa të vërteta, natyrisht edhe të ndryshojmë sjelljen e prindërve në ndërtimin e raporteve reciproke me adoleshentët dhe të rinjtë. Në radhë të parë prindërit, të cilët në shumicën e rasteve nuk kanë të drejtë të besojnë, se paternalizmi është mënyra më e duhur e trajtimit apo shikimi i tij si mjet që ka forcë dhe ndikim edukativ mbi adoleshentët. Ata sot janë ndryshe. Ndryshe janë dhe raportet edukative. Prandaj realitetet duhen njohur dhe pranuar ashtu si janë.

Të gjithë filozofët, pedagogët dhe sociologët e kohës postmoderne, janë të mendimit se në “luftën mes brezave”, në mënyrë të natyrshme dhe organike kanë ndryshuar vendet midis prindërve dhe adoleshentëve. Koha ka vërtetuar përgjithësisht se fëmijët dinë më tepër sesa prindërit. Kjo është dialektika e kohës që duhet pranuar, në mënyrë që të mos kemi konflikte banale në marrëdhëniet me adoleshentët dhe me të rinjtë tanë. Prindërit nuk ka pse të ndihen të ofenduar kur adoleshentët reagojnë ndaj formave të vjetra paternaliste të edukatës atërore. Është kohë e vështirë edukative dhe akoma më i vështirë është synimi, që vetë prindi në këto relacione e marrëdhënie të jetë model edukativ, shembull imitimi për fëmijët e tij.

Vetëm duke ndryshuar dhe duke kuptuar kohën, natyrën e të rinjve dhe të adoleshentëve, mund të bëhemi prindër dhe edukatorë, mbështetës për synimet materiale, edukative, emocionale, morale dhe intelektuale të tyre. Ky është imperativi

edukativ i kohës, mjeti për të shmangur paternalizmin e bezdisshëm, konfliktet e panevojshme prind-adoleshent në familjen shqiptare.

Edukimi, proces i vështirë, por i domosdoshëm

Në shoqërinë shqiptare janë shtuar shqetësimet sociale, ankesat individuale, zërat e njerëzve, të grupeve sociale dhe të institucioneve të edukimit. Sidomos të alarmuar janë ata, që janë rritur në sistem tjetër social, që janë edukuar me parime ideologjike të jetës supersociale dhe të edukatës kolektiviste, kur përballen me dukuritë dhe problemet e ndërlikuara edukative, me të cilat po përballlet shoqëria dhe qytetërimi ynë, i konceptuar dhe i ndërtuar përfundimisht mbi parime të qytetërimit liberal.

Mua më ndodh shpesh që njerëz, të cilët i lexojnë artikujt e mi me temë sociale, ose që shikojnë emisionet me tematikë edukative në televizion, më takojnë, më shkruajnë, me telefonojnë të shqetësuar për interpretimet që kam bërë për shoqërinë postmoderne dhe për dukuritë komplekse të qytetërimit liberal shqiptar. Shqetësimi, që ndihet më shumë, është i lidhur me disa pyetje që bëjnë shumica e tyre: A është qytetërimi ynë më shkatërrues se më parë, a është bërë njeriu një qenie fare e shturur, pa norma dhe rregulla sociale? Ç' duhet të bëjmë me ta?

Natyrisht nuk është e lehtë t'u japësh përgjigje të prera njerëzve për këtë situatë sociale kaotike, në të cilën ndodhet jo vetëm shoqëria jonë, por përgjithësisht shoqëria universalisht. Gjithë problemi është si mund të sigurojmë ndërtimin e një

qytetërimi, në të cilin të bashkëjetojë harmonikisht njeriu i lirë dhe shoqëria e tij, si mund të kombinojnë objektivat e tyre, si mund të “disiplinohet” sjellja e njeriut në kushtet e shoqërisë së lirë, pa detyrime dhe “penalitete shtetërore”, si mund të edukojmë njeriun përmes vënies në funksion edukativ të makinerisë gjigante dhe moderne të edukimit qytetar, në mënyrë që zgjerimi i autonomisë personale të mos pengojë detyrën e koordinimit social të njeriut me shoqërinë tonë?

Në ç’ mënyrë duhet vepruar për edukimin e njeriut, në kushtet e sotme kur kanë kaluar këto dy dekada të demokracisë, kohë kur ka rënë shumë “mendjemadhësia e makinës megalomane të efektivitetit të sigurt në edukimin e dikurshëm”? Kush e zëvendëson atë në shoqërinë tonë dhe si mund të realizohet procesi i edukimit qytetar?

Nuk ka dyshim që në shoqërinë tonë janë dobësuar lidhjet e njeriut me institucionet e edukimit, por edhe këto të fundit duke ndierë pafuqinë e tyre, kanë filluar të zbehin punën, madje të braktisin detyrimin e tyre social-edukativ. Nuk është në situatë të mirë edukative familja, shkolla, shoqëria civile. “Mikropushteti edukativ” i tyre ka humbur pjesë të ndjeshme të autoritetit, madje ky “pushtet” ka rënë moralisht. Impakti pozitiv i tyre është në erozion të thellë. Edukimi është kthyer në një proces më shumë spontan e kaotik, pa rregulla, pa objektiva dhe synime sociale. Lidhjet e njeriut me kulturën qytetare si fundament i formimit liberal, janë dobësuar.

Është zgjeruar, madje liberalizuar deri në ekstrem “sistemi i lirive”, por ndërkaq, shoqëria jonë duket sikur nuk ka më “sistem” pengesash sociale dhe “penalitete edukative” të vogla, si ndjenja që formohen me fëmijët në familje, me nxënësit në shkollë, me ushtarët në ushtri, me pacientët në spital, me

qytetarët në komunitet, me fqinjët në pallat etj. Një proces ky shumë i domosdoshëm për t'u rindërtuar në shoqërinë tonë, për të formuar njerëz përmes edukimit kulturor dhe qytetar. Institucionet e edukimit social kanë filluar të ndihen keq dhe përballë vështirësive, anarkisë dhe kaosit edukativ liberal, ato të duken sikur janë në gjendje nokdauni, të kapitulluara, të paafta për të “rimarrë territorin” e duhur të ekskluzivitetit të ndikimit të domosdoshëm edukativ.

Nuk është demokracia e gjerë dhe liberalizmi social shkak për të justifikuar këtë anomali edukative që ka shoqëria shqiptare sot. E keqja duhet gjetur atje ku qëndron. Prandaj në vend që të gjejmë rrugë të shkurtra të qëndrimit konservator edukativ, është më mirë të kërkojmë dhe të gjejmë të vërtetën e kësaj situatë sociale.

Sipas meje, nëse ka ndonjë defekt, që në pamje të parë duket sikur është pasojë e liberalizimit të jetës në shoqërinë shqiptare, ajo nuk është prania e “lirisë së tepërt” shoqërore, por mungesa e efikasitetit të pushteteve të vogla të institucioneve të edukimit, të atyre që kanë forcë të vendosin “pushtetin e normës sociale” të qytetërimit tonë, që janë kode të domosdoshme të bashkëjetesës sociale të pranuar të sjelljes së individit në familje, në shkollë, në jetën komunitare, në spital, në ushtri, në komunitet e kudo ku ka jetë sociale.

Ky është një shqetësim i madh për shoqërinë tonë sepse po krijohet një aliazh i keq social, që vjen si rezultat i shpërpjesëtimeve strukturore të roleve tradicionale të pushtetit edukativ, midis zgjerimit të lirisë personale, zmadhimit të hapësirës së autonomisë individuale nga njëra anë, dhe kufizimit të natyrshëm të “fuqisë penale” të shtetit kur është fjala jo për krime, por për çështjet e sjelljes së vogël

antiedukative të njeriut. Kjo ka bërë që të duken shfaqje të anarkisë së sjelljes sociale, si rezultat i neglizhimit të padrejtë, të pamerituar, jo qytetar të rolit dhe forcës së institucioneve të sigurisë morale dhe të edukimit.

Jeta sociale e shoqërisë sonë po dëmtohet ngaqë ajo nuk ka dhe nuk mund të ketë kuptim pa praninë e “normave sociale” të caktuara konsensualisht për sjelljen njerëzore individuale. Pa dyshim ka një rregull universal të funksionimit të shoqërisë së lirisë, sipas të cilit sa më shumë të dobësohet pushteti dhe kontrolli i shtetit mbi individin e lirë, aq më shumë duhet të forcohet dhe të kompensohet pushteti natyral i edukimit të shoqërisë civile dhe institucioneve sociale, aq më shumë duhet të rritet fuqia ndikuese e “mikropushtetit edukativ” të tyre, pa të cilën liria mund të degjenerojë në anarki. Pushteti i shoqërisë civile dhe institucioneve sociale, nuk është frenues dhe penalizues, por është siç thotë Mishel Fuko, obsional dhe efektiv.

Pa dyshim një shoqëri sado e lirë që të jetë ka nevojë që të ketë në funksion dhe në efikasitet të plotë “makinerinë e edukimit” qytetar, që është ajo tërësi e institucioneve që shoqëria jonë praktikisht dhe fizikisht i ka, por efektiviteti i tyre është zbehur keq. Kjo do të thotë se, në kushtet e lirisë, ato që kanë më shumë përgjegjësi të veçantë edukative në shoqërinë shqiptare, më shumë se në kohën e “rolit edukativ” të shtetit totalitar, sepse ato janë dhe mbeten institucionet e vetme themelore të edukimit dhe të disiplinimit qytetar të njeriut të lirë, modern, duke filluar nga familja, shkolla, ushtria, komuniteti pse jo në një masë indirekte edhe shteti. Sepse shteti nuk mund të jetë indiferent përballë përgjegjësisë që ai ka për të vlerësuar,

ndihmuar dhe përmirësuar cilësinë e funksionimit të këtyre institucioneve.

Nuk është mirë, për nivelin e qytetërimit tonë, që të bëjmë gabime fatale, duke menduar se liria qytetare ka si ekuivalent të saj ekzistencial, jo vetëm largimin e pushtetit të shtetit, por edhe braktisjen e institucioneve të edukimit. Kjo ka bërë që të jemi në një situatë sociale shqetësuese, jo të mirë dhe aspak dinjitoze për standardet e qytetërimit tonë.

Duhet të merremi të gjithë dhe gjithmonë e më shumë me problemet e thella që po ndeshim përditë, të cilat kanë të bëjnë me mosfunksionimin si duhet të mekanizmave të makinës sociale të edukimit që kemi në dispozicion, duke filluar nga familja, shkolla, spitalet, ushtria, komuniteti dhe nga institucione të tjera ku rrjedh e përbashkët jeta publike e njeriut. Të jetosh në liri do të thotë të njohësh dhe të zbatosh “normat sociale”, kulturën e jetesës së përbashkët, të lirë por të qytetëruar, e cila nuk i jepet njeriut si “paketë edukative” dhuratë nga shteti, por është një art i vështirë që mësohet pikërisht në këto institucione edukative, të cilat i kemi në shoqërinë tonë dhe që jo vetëm nuk duhet t’i braktisim, por përkundrazi t’i perfeksionojmë më tej.

Nuk ka shoqëri të lirë pa praninë konsensuale dhe qytetare të disa “limiteve të sjelljes sociale”, në të cilat duhet të rrjedhë jeta jonë e përbashkët. Po kush i vë këto limite në shoqëri? Shteti vendos ligje dhe ka detyrë të kërkojë zbatimin e tyre kundrejt penalteteve për shkelësit e tyre, të cilat janë gjithnjë përgjegjësi individuale. Por nuk është fjala vetëm për këto, por është fjala për disa limite të tjera, me natyrë sociale dhe edukative, që duhet të bëhen organike për të gjithë ne si qytetarë, të paktën për të ndërtuar “bazën dhe themelin” e qytetërimit në nivel mesatar.

Ne jemi të shqetësuar sepse në shoqërinë shqiptare jo vetëm po shtohen ata që shkelin ligjet e shtetit dhe që janë dënuar penalisht (të cilët janë shtuar shumë), por sidomos për ata që kanë defekte të rënda, të shfaqura në mungesën e dinjitetit qytetar, në mungesa të normave të sjelljes, në deformime dhe shformime të personalitetit social, që nuk njohin dhe nuk zbatojnë “rregullat e lojës” qytetare, të lirisë, të qytetërimit, të bashkëjetesës komunitare.

Pasoja të njohura këto, të lidhura me defektet e dobësisë së shoqërisë civile dhe inefiçencës së institucioneve të edukimit në Shqipëri. Në radhë të parë të familjes dhe shkollës, ku merren bazat e edukimit qytetar, ku mësohen “rregullat e lojës” që ndihmojnë në procesin e përshtatjes së njeriut me parimet dhe modalitetet e jetës në shoqërinë e lirë.

Më së pari sipas mendimit tim, përgjegjësi të veçantë ka shkolla si institucion i kulturës, i disiplinës dhe i edukimit qytetar në të cilën të rinjtë në moshën e formimit të personalitetit mësojnë bazat e kulturës së qytetërimit liberal, bazat e sjelljes komunitare, të respektimit të dinjitetit personal të “vetes” dhe të “tjetrit”, që janë kusht ekzistencial i domosdoshëm për të hyrë në “shoqërinë e lirisë”, me dinjitet personal të formuar dhe me aftësi të integruara të sjelljes sociale. Ne duhet të pranojmë, që nëse shkolla jonë ka arritje të mira në formimin intelektual të të rinjve kjo nuk duhet mohuar.

Por në të njëjtën kohë, duket se shkolla ka probleme serioze në punën e dobët edukative që bëhet dhe që ka pasoja në formimin e gjymtuar qytetar të të rinjve. Defektet e saj, bashkë me neglizhimet e njohura të një pjese të konsiderueshme të familjeve shqiptare, kanë krijuar këtë situatë që përjetojmë në vendin tonë. Nuk e kanë gabim sociologët që thonë se ...

kultura e fituar përmes arsimit është prona dhe investimi më i rëndësishëm i njeriut, sepse ajo i jep qasje qytetare në të gjithë sferat e tjera të jetës.

Në kontekst filozofi i shquar, Ernest Gellner, si mjeshtër i anatomisë dhe i rolit të institucioneve edukative, mendon se “Identiteti i tij më i fshehtë (i njeriut-shënimi im) nuk është i përcaktuar nga bilanci i tij bankar, as nga farefisi dhe as nga statusi i tij, por nga kultura e tij shkollorë”¹. Si përfundim, duke dashur që të kthej një përgjigje për miqtë e mi, që më kanë bërë pyetje, më duhet të them sinqerisht i bindur se nuk ka faj shoqëria liberale për situatën tonë social-edukative, sepse këto mungesa të evidentuara janë pasoja të punës dhe dobësive të “makinerisë edukative”, nga e cila po krijohen njerëz, shtresa dhe grupe sociale që jetojnë në periferi të shoqërisë.

Ata shpesh shfaqen të vetmuar, asocialë, patologjikë, brutalë, kriminelë, vrasës, paranojakë, të droguar, bastardë në sjellje me familjen dhe prindërit, të dhunshëm deri në sadizëm me gratë dhe fëmijët, anarkistë, që nuk njohin dhe nuk respektojnë rregullat e bashkëjetesës sociale të shoqërisë, që pa dyshim janë shqetësim i madh social, që nuk vijnë nga liberalizimi i jetës shoqërore, por nga mangësitë e procesit të deformuar të edukimit qytetar, dhe që mund të zgjidhen po përmes intensifikimit dhe modernizimit të punës dhe vënies në punë me kapacitet të plotë të “makinerisë edukative” të shoqërisë sonë.

Nëse kjo “makineri” nuk punon si duhet ose punon me defekte, atëherë doemos që liria do të degjenerojë në anarki sociale, kështu shoqërisë sonë di t’i shtohen njerëzit anormalë,

¹ E. Gellner, “Konditat e lirisë”, f. 179.

të cilët nëse shtohen me këto ritme atëherë me siguri do të përbëjnë rrezik për mbrojtjen sociale dhe për sigurimin e ekuilibrave qytetarë të shoqërisë sonë. Ndaj duhet të merremi me edukimin e vetes dhe të shoqërisë sonë, duke “rindezur” dhe duke vënë në efikasitet sociale të gjitha institucionet e edukimit, me qëllim që të punojmë për të shmangur dy të këqija të mëdha të kohës sonë: edukimin primitiv, të lodhur të institucioneve që imitojnë “mendjemadhësinë edukative” kolektivistë të komunizmit dhe neglizhencën e spontanitetit të “vetedukimit liberal”. Na duhet edukim që njëherësh formon njeriun në vetvete si qytetar dhe që nga ana tjetër e mëson atë të veprojë sinkron me bashkësinë. Ky është qytetërimi liberal që duhet të synojmë.

Edukimi dhe natyra e “ndërlikuar” e njeriut postmodern

Nuk është e lehtë në kohën tonë të “përkufizosh” se cili është edukimi që duhet të marrë njeriu që të jetë qytetar i edukuar. Madje nuk kemi të qarta se cilat vlera të sjelljes individuale dhe të sjelljes sociale i duhen njeriut, kohës, shoqërisë, se cilat prej tyre duhet të konsiderohen vlera morale apo tipare të domosdoshme për shoqërinë shqiptare të ditëve tona.

Kjo çështje nuk është problem i thjeshtë moral ose pedagogjik. Është një nga problemet e mëdha sociale, që ka sjellë shumë shqetësime konceptuale dhe praktike në veprimtarinë edukative të familjes, shkollës, institucioneve fetare në Shqipëri, Ne jetojmë në një shoqëri të lirë, të individualizuar, me tregues edukativë të tronditur, me ndikim

të ulët social, prandaj nuk është e lehtë të përcaktosh se cilat janë tiparet morale dhe karakteristikat personale që duhet të ketë dhe të shfaqë njeriu, për të qenë koherent me kërkesat dhe imperativat e jetës moderne.

Në të vërtetë çdo ditë e më shumë po përballemi me perceptime edukative kaotike, madje me koncepte voluntariste antiedukative, shpesh të deformuara deri në kufijtë e anarkisë dhe anomisë sociale. Shumë të rinj të shkollave të mesme, studentë të universiteteve, por jo vetëm, kanë dalë realisht nga “kufijtë e lejuar” të lirisë personale dhe po bëhen shqetësim i vërtetë social. Krimi, vrasjet, vjedhjet, dhuna, tensioni social, publik, janë tregues të faktit që perceptimet anarkiste të lirisë nga shumë njerëz dhe grupe sociale në shoqërinë tonë, kanë krijuar rrethana të favorshme për një situatë të paqartë për vlerat që i duhen qytetërimit tonë.

Po bëhen dy dekada që nuk po merremi si duhet me edukimin e njerëzve, sepse e gjithë shoqëria është në sulm për para, mirëqenie, mbijetesë, luks, konsum, seks etj. Dhe kjo ka krijuar gradualisht një situatë sociale në të cilën shumë njerëz nuk e kanë aspak të qartë, madje kanë një perceptim “flu”, të disa vlerave morale të domosdoshme që duhen për ekuilibrin e shoqërisë shqiptare në tërësi, por edhe për jetën individuale të njeriut.

Ky “boshllëk moral” duket se është zgjeruar akoma kohët e fundit. Madje duket se po ecim deri në kufij kritikë. Kjo e ka bërë të vështirë punën për edukimin dhe veçanërisht të të rinjve në familje, në shkollë dhe në komunitet. Sepse edhe këto institucione ndodhen përballë vështirësive konceptuale për të përcaktuar se cilat janë vlerat edukative, tiparet morale dhe standardet e qytetërimit që duhen kultivuar tek njerëzit

tanë. Akoma më e vështirë është situata në kushtet e zgjerimit të tendencës liberale, aq sa në pamje të parë duket se e kanë të vështirë disiplinimin e vullnetshëm të njeriut në shkollë, në familje ose në institucionet e tjera specifike të edukimit.

Jo vetëm kaq, por nuk është pa shqetësim fakti që këto institucione vetë nuk kanë njohuritë, teknikat e teknologjitë e duhura edukative që e bëjnë akoma më të vështirë procesin e ndikimit modern edukativ. Këtë vështirësi, në të njëjtin drejtim dhe me të njëjtën “gjatësi vale”, e kanë edhe figurat kryesore profesionale, që në pozicione të caktuara kanë misionet edukative familjare ose sociale.

Prindi në familje dhe mësuesi në shkollë, punonjësit e institucioneve të tjera edukative nuk janë të qartë dhe së pari se çfarë aftësish morale duhen kultivuar në kohën e tanishme në personalitetin e njeriut modern si qytetar, dhe mbi të gjitha si mund të ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për formimin e këtyre tipareve. Kjo ka bërë që shpesh puna edukative me fëmijët në shkollë dhe në familje të ketë natyrë kaotike.

Kërkesat dhe synimet janë më shumë përzierje parimesh edukative të vjetra ose sajesa intuitive, aliazhe hibride jofunksionuese midis tezave të vjetra të moralit tradicional, mbeturinave të kërkesave të edukimit komunist, apo produkte imitimi ekzibicionist të bazuar në parime kakofonike pedagogjike e morale, që më shumë se ta ndërtojnë e deformatojnë karakterin dhe personalitetin e njeriut. Një gjë duhet të kuptojmë të gjithë. Në çdo rol dhe pozicion që jemi si prind, si: vëlla, motër, mësues, pedagog, mjek, punonjës social, psikolog, që procesi i edukimit të njeriut në shoqërinë moderne të individualizuar, nuk është më aq i ngarkuar me

parafabrikate e slogane ideologjike dhe edukative, por është bërë ndërkaq shumë i vështirë dhe i ndërlikuar.

Prandaj sociologët dhe pedagogët e kohës postmoderne kanë ravijëzuar një koncept edukativ më të thjeshtë, të bazuar në një pragmatizëm moral, i cili synon që të ravijëzohen te qytetari minimalisht “dy aftësi” bazë, që i duhen për të qenë i orientuar, i suksesshëm në jetë. Sepse sado individuale të bëhet shoqëria jonë, ajo nuk mund t’i shmanget nevojës dhe domosdoshmërisë që kanë njerëzit për të komunikuar me njëri -tjetrin, për të pasur mes tyre lidhje të natyrave intime dhe të nevoja të pashmangshme për kooperim social. Kjo se njeriu jeton në shoqëri jo si qenie e izoluar, por si individ me dimension social.

Natyrishit që të jetë në këtë pozicion normal me veten dhe me shoqërinë, është e nevojshme që institucionet e edukimit dhe edukatorët socialë të punojnë për të krijuar atë formim human në familje, shkollë dhe komunitet. Filozofi, sociologu dhe politologu amerikan, John Rawls, duket se e ka zgjidhur këtë formulë, duke theksuar se sot është imperative që të punojmë për të krijuar “dy aftësitë morale” të njeriut. Sipas tij edukimi duhet të synojë në të gjithë hallkat e edukimit që te njerëzit të kultivohen si tipare themelore të personalitetit të tij “sensi i drejtësisë” dhe “sensi i së mirës”.

Në pamje duken si gjëra të thjeshta, por në thelb ato janë vlera morale sintetike, të përbëra, që në kuintesencën e tyre kanë të materializuar shumë vlera të tjera. Nuk mund të normalizohet shoqëria, nuk mund të funksionojë si duhet demokracia shqiptare dhe morali i saj nëse te njerëzit tanë në familje, në shkollë, në administratë, në komunitet e kudo, në jetën publike dhe sjelljen private nuk kultivojmë një “sens

drejtësie”. Kjo do të thotë që tashmë të gjithë duhet të synojmë të edukojmë njerëz me aftësi qytetare për të zbatuar principet e drejtësisë politike në shoqëri.

Pa këtë ndjenjë konsensuale, të përgjithshme, sunduese të njerëzit tanë është e pamundur të funksionojë shoqëria si sistem social i përbërë. Pa ndjenjën e drejtësisë si veprim organik i çdo njeriu si qytetar, është e pamundur të krijohen pastaj kushtet që njerëzit të lidhen mes tyre përmes nevojës së kooperimit social.

Por krahas këtij tipari, është me rëndësi të krijojmë kudo dhe te çdo njeri sensin e orientimit organik drejt së mirës, duke e bërë atë tipar të qëndrueshëm të personalitetit të njeriut si qytetar. Kur themi të edukojmë nxënësit, të rinjtë dhe të gjithë qytetarët me ndjenjën dhe konceptin e së mirës, nuk është fjala për konceptime metafizike të saj, sesa më shumë për disa tipare të mënyrës së sjelljes së njeriut postmodern. Kjo ka të bëjë me vlerën e jetës njerëzore. Pa dyshim në skalitjen e këtyre tipareve të qytetarit është e domosdoshme dhe e dobishme që të angazhohen edhe doktrinat fetare, filozofike dhe morale, institucionet e tyre specifike, ndikimi i të cilave në shoqërinë tonë për fat të keq është fare i ulët.

Sepse shoqëria ka nevojë, nevojë kanë dhe edukatorët e çdo niveli duke filluar që nga politikanët. Sensi i “drejtësisë” dhe i së “mirës” duhen zbërthyer konceptualisht dhe pastaj të bëhen module organike të punës edukative me familjen, shkollën dhe me të gjitha institucionet e tjera të edukimit.

Domethënë ne si shoqëri tashmë kemi nevojë urgjente, kjo sipas mendimit tim, që të ndryshojmë konceptin e vjetër të edukimit dogmatik dhe moralizues të së kaluarës, me të cilën kemi vlerësuar personin e moralshëm. Paradigmat etike të

vlerësimit moral të së kaluarës ndihen ende në konceptimet vlerësuese që shpesh bëjmë edhe për njeriun e ditëve tona, pa llogaritur kohën që ka ndryshuar dhe njeriun që tashmë është bërë “tjetër njeri”. Pavarësisht konfondimeve dhe keqkuptimeve që ka për vlerësimin e njeriut të moralshëm, të suksesshëm, një gjë është e vërtetë.

Kjo shoqëri në të cilën jetojmë është konceptualisht, ontologjikisht dhe empirikisht krejt tjetër. Ketmanët moralë me natyrë sociale gjithnjë e më shumë po e humbasim forcën e ndikimit, sepse është zbehur shumë moraliteti social si diçka që vjen nga lart dhe po zgjerohet së tepërmi baza dhe hapësira e moralitetit individual, aftësia e njeriut për të pasur konceptin e vet praktik, individual, të përveçëm për atë që është e mirë apo e keqe, e moralshme apo e pamoralshme.

Në shoqërinë tonë, që tashmë ka si “ideologji” të vetën pragmatizmin, vlerësimin mbi gjithçka të asaj që të shërben në jetën tënde, që është e dobishme dhe të sjell sukses, është e vështirë të kërkojsh kodifikime morale me natyrë të gjerë sociale. Në këtë kontekst të jesh i moralshëm sot nuk do të thotë që të mos jesh i fortë, ambicioz, i renditur në punë, me mendim të qartë agresiv për progresin, individualist në një masë gjithnjë e më të madhe.

Në të vërtetë në kohën moderne më shumë sesa flitet për “shoqëri morale” flitet për shoqëri me drejtësi. Në vend të njeriut të moralshëm po synohet të krijohet qytetari, që duke kristalizuar tiparet e qytetarisë të bëhet njeri i drejtë, që zbaton rregullat dhe ligjet e shtetit, pa pasur nevojë për epitete morale pasive shtesë që nuk i sjellin dobi as atij e as shoqërisë. Në kohën tonë parimet e vjetra morale nuk funksionojnë.

Koha kërkon tjetër gjë. Kjo do të thotë se duhet të ndryshojmë konceptin dhe synimet e edukimit moral, strategjinë, taktikën, praktikën e edukimit të njeriut, duke synuar dy gjëra të mëdha që i duhen kohës sonë.

E para, të synojmë që të edukojmë njeriun jo me parime dhe vlera morale që nuk i shërbejnë atij, kohës dhe shoqërisë postmoderne, dhe të ngulim këmbë që të formojmë kushtet morale të formimit qytetar të çdo njeriu individualisht, me parime dhe norma të qytetërimit universal. Në këtë botë njerëzore të integruar, të globalizuar, ajo për të cilën kemi nevojë është formimi i njeriut me standarde morale të barabarta dhe me vlerat universale të qytetërimit.

Dhe së dyti, paralelisht me formimin qytetar duhet të punojmë “skalitjen” e tipareve morale që i përshtaten kohës dhe njeriut (duhet kujdes në përdorimin dhe pretendimin për aq shumë humanizëm, solidaritet, miqësi, fqinjësi etj.), krijimit të qytetarit me “shpirt drejtësie”.

Është koha e duhur që të përqendrohemi në këtë “doktrinë morale” me qëllim që t’i shërbejë efektivisht shoqërisë dhe formimit qytetar të njerëzve tanë. Krijimi te njerëzit tanë i konceptimit dhe veprimit si qytetar, me sens organik “drejtësie dhe mirësi” është një proces më shumë filozofik, psikologjik dhe politik dhe fare pak me fundament moral. Prosesi i edukimit qytetar, formimi i sensit të drejtësisë morale duke filluar nga fëmija i kopshtit e deri tek i moshuari është detyrë parësore e shoqërisë sonë, kusht i lehtësimit të procesit universal të integritetit të njerëzve tanë në qytetërimin që tashmë universalizohet pa kthim.

Formimi qytetar dhe ndjenja e drejtësisë njerëzore (në të cilën janë të shkruara në përputhje me kohën dhe në masën e

nevojshme humanizmi, solidariteti etj.) është një proces më shumë politik sesa moral. Kjo do të thotë se ne kemi nevojë për të edukuar në çdo cep të shoqërisë shqiptare, jo njerëz demagogë a dogmatikë, por qytetarë të vërtetë që respektojnë vullnetarisht dhe jo nga frika ligjet e vendit, Kushtetutën, të drejtat dhe liritë e njeriut, traditat dhe zakonet më të mira që kemi. Koha kërkon që këtu të përqendrojmë “bateritë e edukimit” të njeriut dhe jo të ecim duke u hallakatur kot në “shkretëtitrat morale”, duke u marrë me mekanizmat e ndryshkur edukativë të kohës së shkuar.

Edukimi, tradita dhe imperativi kohës

Sa herë që prindërit, mësuesit, edukatorët, sociologët, pedagogët tanë ose media e shkruar dhe elektronike analizojnë tipologjinë e shfaqjes dhe mënyrat e “reja” të sjelljes së njerëzve tanë, gjithnjë ose rast pas rasti përveç vlerësimit të ontologjisë së sjelljes së njeriut të sotëm, ata bëjnë edhe krahasime me njeriun, me shoqërinë dhe mënyrën e sjelljes në shoqërinë tonë të së kaluarës.

Në këtë rezultante atyre, por edhe të gjithë neve të tjerëve, rezultatet na dalin të paqarta, konfuzë ngaqë me sa duket sistemi i krahasimit nuk është i sigurt, por as vlerat në vetvete, me të cilat ne bëjmë krahasimin e sjelljes së njeriut të sotëm me atë të njeriut të djeshëm, nuk janë as të qëndrueshme, as me fuqi sociale konstante në sistemin e vlerave edukative.

Shpeshherë e gjithë kjo piramidë sociale me funksione edukative në përpjekjet e veta të sinqerta për të ndikuar në procesin e madh dhe të vështirë të edukimit, në punën

për të ndërtuar sistemin e edukimit të njeriut është gjithnjë në dilemën konceptuale të presionit nga njëra anë të imperativave të kohës dhe nga ana tjetër përballë një tradite edukative të trashëguar nga e kaluara. Midis këtij sistemi kaotik impertivash dhe vlerash është vështirësia e punës për t'u marrë me efikasitet dhe për të edukuar njeriun, i cili që në kohën e sotme ka disa parametra të veçantë.

Ai është dhe duket liberal, i pabindur, i padisiplinuar, i shpërndarë, kaotik, më shkurt pa “dimension edukativ” të qartë që të mundëson nga ta “kapësh”. Në të vërtetë kjo mënyrë sjelljeje që neve ndonjëherë na duket jonormale dhe e çuditshme, vjen ngaqë jemi mësuar me edukatën e “jesmenëve” të “turmës sociale” të së kaluarës. Tani është fare normale të njihet dhe të pranohet; njeriu i kohës postmoderne e pranon edukatën, por kërkon që edhe të marrë pjesë vetë në edukimin e tij, duke pranuar, por dhe duke kundërshtuar ato që nuk i pëlqejnë apo që nuk i vlejnë. Ai nuk pranon që edukata t'i shtypë personalitetin ose t'i deformojë individualitetin.

Edukimi sot është i vështirë sepse nuk kemi më ekzistenca sociale të organizuara si turma të vëna në rresht, por përballemi me njerëz të larmishëm që kanë “ekzistenca edukative” shumë të ndryshme, që kanë dëshirë dhe pëlqejnë lirinë e tyre. Është e vështirë puna edukative, është i ndërlikuar sukcesi në një shoqëri në të cilën njerëzit kanë vënë në pikëpyetje besimet e mëdha, opinionet e trashëguara, siguritë e njohura, parimet e ngurta dhe zakonet e vjetra të së kaluarës. Kjo është situata në të cilën ndodhemi sot dhe që duhet njohur nga të gjithë, veçanërisht nga ata që kanë role, misione edukative në familje, në shkollë, në komunitet etj.

Njeriu është qenie e vështirë për edukim ose për manipulim edukativ. Sa herë që arsyetojmë për këtë situatë, gjithnjë e më shumë njerëzit, që në shoqërinë tonë janë të ngarkuar me funksione dhe misione edukative, janë të shqetësuar me mënyrën e veçantë sesi njeriu po organizon jetën personale, me manierat e shumta të shfaqjeve të saj, të cilat në jetën e shoqërisë postmoderne janë të shumta.

Fare lehtësisht duket e qartë prirja, tendenca e pakthyeshme, tentativa këmbëngulëse dhe dëshira frenetike e njeriut që të jetë sa më larg ndikimit edukativ, të bërë sipas metodës tradicionale të përpunimit me anë të “parafabrikateve sociale”, paradigmeve dhe parimeve të ngurta edukative të jetës kolektive.

Në shoqërinë shqiptare me gjithë ndryshimet me natyrë të thellë individualiste që kanë ndodhur, të cilat për hir të së vërtetës janë bërë prirje dominante të jetës sociale dhe individuale, trende të vrullshme të jetës sa kaotike, po aq dhe moderne, tradita, trashëgimia morale dhe parimet konceptuale sociale kanë ende ndikim të gjerë në shumë mjedise dhe për shumë kategori sociale.

Sidomos pesha e trashëgimisë së të kaluarës duket qartë dhe pasqyrohet në shumë vlerësime zyrtare, në interpretimet mediatike të dukurive të jetës sonë sociale postmoderne. Ky është një realitet që tashmë ndikimi i tij është delikat dhe kontroversal, që po na sjell moskuptime konservatore, por dhe veprime të pastra të braktisjes së edukimit në emër të anarkisë liberale. Pavarësisht se koha ka ndryshuar, nga njëra anë në punën edukative konceptualisht dhe kontekstualisht në familje, në shkollë, në mjediset publike dhe kudo ku zhvillohet veprimtari e drejtpërdrejtë apo e tërthortë

edukative ne përballemi me fuqinë ndikuese apo edhe frenuese të disa simboleve, simbolikave morale, zakonore, historike dhe ambientale që i kemi të trashëguara nga jeta e superkolektivizuar e socializmit, por që për kohën moderne janë të vjetra.

Në shoqërinë tonë situata e komunikimit edukativ me njerëzit është bërë e vështirë ngaqë ka një kontradiktë reale. Sepse në këto momente duket se ne kemi përfunduar etapën e tranzicionit politik dhe ekonomik (megjithëse edhe këto, sipas mendimit tim, jo deri në fund). Ndërkaq, ende nuk kemi mbaruar etapën e përfundimit të tranzicionit moral, sidomos atë të ndërtimit të standardeve të qytetërimit dhe rregullimin e moduleve të komunikimit qytetërues. Kjo është arsyeja, që akoma në shoqërinë tonë ka njerëz nostalgjikë, që gabimisht mendojnë se jeta jonë në të kaluarën ka qenë më e qetë, ka qenë “jetë sociale ideale”.

Dhe për këtë si kundërgargument të sjellin ndryshimet kaotike që po ndodhin në shoqërinë shqiptare të ditëve tona, sidomos duke u mbështetur në disa aspekte të jetës sociale, morale dhe personale. Është e vërtetë që në shoqërinë shqiptare është duke ndodhur një “revolucion i vërtetë” moral dhe zakonor, po ngrihet jeta moderne e cila po sjell transformime të thella në rivlerësimin e traditës morale, zakonore të shoqërisë sonë e cila tashmë nuk ka më forca të interesuara për t’i bërë të ngurta, të qëndrueshme, të pandryshueshme.

Në këtë sferë asnjëherë ndryshimet që bëhen me përmbysje, ato nuk janë të sigurta nëse janë tërësisht të qarta dhe të sakta. Kjo e vërtetë që u vërtetua në politikë duket se po ndodh edhe në jetën morale të shoqërive që po tranzitojnë drejt postmodernitetit. Por, megjithatë unë mendoj se ne nuk kemi

rrugë tjetër, për të ndryshuar dhe për të përmirësuar qytetërimin tonë në këto aspekte. Prandaj duhet të ndikojmë tek njerëzit tanë, për të kuptuar imperativin e ndryshimeve të thella që kanë ndodhur, duke prekur apo më saktë edhe “përmbysur” disa nga modulet morale, zakonore, të traditës sociale dhe sjelljes individuale të shoqërisë shqiptare të së kaluarës, sidomos për martesën, bashkëjetesën, homoseksualizmin, seksualitetin, shoqërinë, familjen, komunitetin etj.

Në fakt po qe se vlerësimet për traditat, zakonet dhe jetën morale të së kaluarës tonë, do t’i bëjmë duke abstraguar nga e vërteta, apo duke harruar që ato kanë pasur vlerë ngaqë kemi jetuar në një format tjetër social, në kuadrin e ngushtë të një “shoqërie të mbyllur”, të determinuar ideologjikisht dhe moralisht, të ndërtuar nga parime jo aq shumë të lira dhe humane, ashtu është. Çdo njeri që nuk kupton tipologjinë e shoqërisë demokratike, e cila kulturalisht dhe moralisht është multikulturore dhe e hapur, me siguri që është i prirur që e kaluara jonë t’i duket e “shenjhtë”, ngaqë në mendjen dhe perceptimin e tyre, duket se i kanë pasur më të “qarta gjërat”, më të “formatuara sendet”, më solide simbolet, zakonet dhe traditat.

Kjo kategori njerëzish, që ka perceptim të deformuar për thelbin e zhvillimeve morale kontradiktore të shoqërisë, për natyrën liberale të kohës postmoderne, nuk kupton se sot në shoqërinë shqiptare është e pamundur të “kthesh kokën pas”, është e vështirë të shpresosh se është më mirë që të ndërtohen marrëdhënie të bazuara kryesisht në “vlerat” e së kaluarës. Kjo jo vetëm është e pamundur, por është moralisht konservatore dhe qytetarisht krejt reaksionare. Më saktë, e pamundur të ndodhë në kushtet kur njeriu po bëhet individualisht

i përveçëm, dhe nga pikëpamja sociale pa dimension të determinuar që të mbërrijë me efekt të qartë edukativ deri në “thelbin e qenies”.

Është e vërtetë që koha postmoderne përgjithësisht i ka të paqarta simbolet e reja morale dhe sjelljet zakonore. Madje të gjithë jemi të shqetësuar me faktin që normat e reja sado individuale, liberale dhe të personalizuara të jenë kanë nevojë për një “konsensualitet social” të përgjithshëm, për të pasur një masë vlere sociale të domosdoshme për ndërtimin e parimeve të përbashkëta të jetës komunitare dhe për respektimin e standardeve të qytetërimit të kohës postmoderne. Nuk mund të mos jemi të shqetësuar për faktin që vlerat e reja të kohës sonë shfaqen shumë kaotike, pa ekzistencën e masës së duhur të “autoritet të jashtëm”, pa mundësitë e duhura që ato të jenë vlera sociale të qëndrueshme dhe në përputhje me kohën, të “bashkëtingëllojnë” me kërkesat dhe imperativat e reja të saj.

Por pikërisht kjo është edhe epërsia e kohës postmoderne që e bën shoqërinë të lirë nga determinimet e ngurta, nga efektet degraduese të moralit fals dhe nga dimensionin social dhe etik i imponuar i njeriut. Nuk është e lehtë që në kohën tonë kur bota mondializohet, kur kufijtë po “rrafshohen”, kur bota po bëhet e hapur, multikulturore, a “nomade”, siç thotë Zhak Atali, të ndërtohet sisteme të sigurta edukimi në shkollë, familje, shoqëri apo në komunitet. Në këtë kontekst, zakonet tona të traditës po përzihen dhe do të përzihen akoma më shumë, për shkak të interferimit postmodern të parimeve të reja të qytetërimit dhe zgjerimit të kontureve bazë të “shoqërisë së hapur”.

Kështu që të kërkojmë të vendosësh në shoqëri “kufij” moralë dhe zakonorë të veçantë, të përveçëm, *sui generis*

për ne shqiptarët është kërkesë sizifiane, një mundim i kotë i shoqëruar me harxhim energjish pa efikasitet dhe pa impakt social. Kjo është e vështirë të ndodhë sepse në botën sociale liberale, që po vazhdon të hapet, nuk mund të ketë zakone sociale fikse dhe tradita të ngurta.

Njeriu ynë të paktën nga kjo pikëpamje është në rrugën e duhur. Ai po bëhet “pa dimension” të ngurtë edukativ, jo në kuptimin se është pa edukatë (kjo mund të jetë e vërtetë po qe se e mendon shenjtërimin e traditës), jo se do të jetë i tillë, por se zhvillimet imponojnë që ai të përshtatet me kushtet e “shoqërisë së hapur”, parimet e “botës së globalizuar” dhe të bëhet kompatibël jo aq me zakonet e mbyllura patriarkale, mënyrat zakonore, modulet provinciale të të sjellurit, por me “parimet e përgjithshme”, normat morale, me ato “vlera abstrakte” të domosdoshme që i duhen qytetarit të kohës postmoderne. Me ato parime që dy shekuj më parë filozofi i iluminizmit, Immanuel Kant, i ka quajtur “vlera abstrakte të qytetërimit universal”.

Është e kotë të ngulim këmbë për të mbajtur gjallë ose për të ringjallur disa nga vlerat tona të së kaluarës, për të cilat nuk ka më shans që të mbijetojnë, në kushtet kur edhe jeta në Shqipëri është postmoderne, e “paqëndrueshme” nga pikëpamja e konceptualitetit të vjetër të vlerave, zakoneve dhe parimeve morale, për pasojë e vështirë për t’u konturuar në shinat e traditës, zakoneve morale. Unë jam në një mendje me atë që thonë sociologët e postmodernitetit, se në vend të tyre shoqëria jonë ka nevojë për “lidhje të tjera”, që janë ndryshe nga lidhjet e ngurta zakonore apo lidhjet e moralit të vjetër patriarkal të shoqërisë sonë të së kaluarës. Sepse me sa duket “Lidhjet që i mbajnë njerëzit së bashku në veprim janë

të shumta, të forta dhe delikate. Por ato janë të padukshme dhe të paprekshme”².

Njeriu postmodern duket se gjithnjë e më shumë i largohet determinimeve absurde, denaturuese edukative e zakonore të së kaluarës. Madje sa më shumë t’i largohet arbitraritetit social dhe imponimeve të padrejta që vijnë nga jashtë, aq më shumë i lirë do të jetë në përcaktimin e dimensionalitetit edukativ individual si qytetar, si qenie sociale. Në shoqërinë tonë njeriu ka filluar të zbehtë respektin dhe vlerësimin e shenjtëruar për traditën dhe zakonet morale e kulturore, sepse me sa duket tani ky njeri është tamam ai që kishte parashikuar Jean-Paul Sartre në kohën e vet që nuk mund të jetojë me “falsifikime dhe maska”.

Prandaj traditat dhe zakonet janë me vlerë sociale për jetën e shoqërisë së qytetëruar, por kur ato vlerësohen në sens mase dhe në përputhje me imperativat e kohës. Të tepërtat, të panevojshmet, të dëmshmet edhe në shoqërinë tonë kanë marrë kurbën e natyrshme të dobësimit të vazhdueshëm, të zbehjes së ndikimit të tyre në formatimin e jetës së individit dhe në procesin e konfigurimit të parimeve të modernizimit të shoqërisë shqiptare të kohës sonë. Në fund të fundit zakonet njerëzore janë të modifikueshme dhe të ndryshueshme.

“Revolucioni edukativ” dhe sjellja njerëzore

Në kohën moderne është bërë shumë e vështirë të kërkosh nga njerëzit që të shfaqen në shoqëri me sjellje personale dhe

² John Dewey, “Publiku dhe problemet e tij”, f. 139.

sjellje sociale shoqërisht të “disiplinuara” deri në instancë të fundit. Këtë të vërtetë po e ndiejmë gjithnjë e më shumë në jetën e shoqërisë, familjes, shkollës, në jetën publike dhe botën e punës.

Sepse këto mjedise sociale tani konceptohen më shumë individualisht dhe këqyren me optika më të lira nga njerëzit dhe nga pikëpamja e mënyrës së jetesës; ato po bëhen më të hapura dhe në këndshikimin e marrëdhënieve me të tjerët janë tashmë mjedise më të demokratizuara. Në këtë kontekst sjelljet dhe qëndrimet morale të njerëzve tanë janë bërë më pluraliste, të papërcaktuara, sepse liritë individuale dhe papërgjegjshmëritë sociale janë zgjeruar aq shumë, sa që në jetën tonë të përditshme kanë sjellë paqartësi, keqkuptime të shfaqura si pakënaqësi sociale në familje, në punë, në jetën komunitare dhe në mjedise shoqërore.

Edukata, procesi i edukimit dhe nevojat e veçanta, që ndihen në shoqërinë tonë për konceptim të ri të punës edukative, të zhvilluar me stil të ri në institucionet e edukimit social, formal dhe informal, tregon se ende “sendet” në këtë fushë delikate nuk janë vendosur në vendin e duhur. Madje, për shkak të “devijimit ultramaterialist” që ka marrë jeta jonë, çështjet, sjelljet dhe problemi “individualizimi i etikës” për fat të keq, nuk kanë arritur të jenë në qendër të debatit publik, kulturor, etik, pedagogjik dhe mediatik.

Duket sikur njerëzit tanë kanë mbyllur “veshët sociale” dhe kanë lënë të hapur vetëm një rrugë të komunikimit me shoqërinë: atë të dëshirave dhe halleve materiale, duke u bërë i fiksuar pas nevojës për mirëqenie dhe konsum. Shoqërisht sipas mendimit tim, tashmë jemi në fazën e rrezikshme që do të këtë në shoqërinë tonë pasoja social edukative, për shkak

të neglizhencës fatal të kësaj pjese që është me rëndësi në ndërtimin e jetës qytetare dhe në plotësimin e standardeve të qytetërimit tonë postmodern. Përshtatja pasive me këtë situatë është shkak i në shoqërinë shqiptare çështjet e edukimit tani nuk janë më probleme me rëndësi të veçantë.

Duke vlerësuar situatën morale dhe devijimet e sjelljeve njerëzore, duhet të pranojmë se ato tashmë janë bërë problem serioz me impakt të gjerë dhe serioz për të sotmen dhe të ardhmen e qytetërimit tonë. Çështjet e edukimit, edukatës dhe sjelljes së njerëzve, po të vlerësohen me realizëm, janë në një pikë kryesore dhe ekzistenciale shumë të vështirë.

Nuk është normale që çështjet e sjelljes dhe problemet e sjelljeve morale të njerëzve të konsiderohen me mendjehetësi sociale si “probleme periferike” të shoqërisë, ose si çështje lineare që rrjedhin natyrshëm në “rrugën e tyre” dhe që më pas është koha ajo që “i zgjidh vetë” në rrugë spontane. Është ky mentalitet joqytetëruar që ndikon në faktin që në shoqërinë tonë, ndërsa problemet e sjelljeve joqytetare janë agravuar ato ende nuk kanë marrë rëndësinë e tyre, nuk janë bërë probleme qytetare, nuk konsiderohen si çështje me vlerë për të ardhmen e shoqërisë dhe qytetërimit tonë.

Në të vërtetë problemet e jetës morale dhe veçanërisht problematikat e mprehta të sjelljeve të shumta me natyrë asociale, që shfaqen në jetën publike dhe private të qytetarit, ka bërë që tashmë të kemi një deformim social të dukshëm, prishje progresive të mjedisit etik dhe të sfondit qytetar në shoqërinë tonë. Ato tashmë jo vetëm janë bërë me peshë ndikuese, por po bëhen edhe të vështira për t’u zgjidhur në rrugën e duhur dhe kjo sepse ndodhemi në një moment kur etika, edukata, edukimi dhe atmosfera edukative janë nën goditjet e forta

shkatërruese, të padrejta, të cilat jo vetëm zhvillohen në sytë tanë, por dhe frymëzohen nga keqkuptimet socioetike dhe filozofike të perceptimit të deformuar të hapësirës së lirisë, së drejtës së individit për sjellje personale.

Është vështirë të dallosh nga pikëpamja etike sjelljet dhe qëndrimet e “lejuara” nga ato të “palejuara”. Deformimi i këtij raporti në shoqërinë tonë nuk është më fenomen sporadik, por është bërë fenomen social i përditshëm, masiv, shqetësues. Të gjithë e ndiejmë këtë shqetësim të shfaqur bujshëm në shoqërinë tonë, nga çdo pozicion që jemi, nga çdo rol që luajmë në shoqëri. Madje situata është e ngarkuar me doza të forta neglizhence bihevisoriste dhe indiferentizmi etik.

Kjo po krijon kushte të vështira, që nuk e bën të lehtë aksionin social edukativ ose angazhimin tonë qytetërues, për t’u marrë me këtë çështje të madhe të jetës sociale, që ka të bëjë me rregullimin e problemeve edukative të shoqërisë shqiptare si “tërësi sociale”, të sjelljes individuale të qytetarëve tanë.

Sepse në këtë betejë etike kemi një “disfavor historik” ngaqë nuk jemi mësuar, as nuk kemi përvojën e edukimit të njeriut në liri. Por nuk kemi të zhvilluar as instrumentet e vetedukimit si proces i natyrshëm i qytetërimit, si veprimtari sistematike dhe e vetvetishme e formimit të qytetarit me normat dhe vlerat e përbashkëta të shoqërisë postmoderne.

Ndaj duhet të mendojmë që, për të pasur shoqërisht suksesin e merituar, për të ecur në “rugën e duhur”, së pari si shoqëri na nevojitet të bëjmë një “revolucion konceptual” social dhe individual, edukativ dhe mendor në mënyrë që të ndryshojmë fillimisht mënyrën e të menduarit për sjelljen e qytetëruar dhe pastaj për vetë sjelljen konkrete të njerëzve, që janë kusht për të larguar shoqërinë dhe veçanërisht organizimet dhe agjencitë

sociale, posaçërisht institucionet specifike të edukimit nga bindjet e vjetra edukative që nuk kanë më shans të japin rezultat në kohën tonë.

Nuk na lejohet të hallakatemi kot dhe ca më tepër të vonohemi për të ecur në rrugën e duhur. “Revolucioni edukativ” mund të realizohet së pari duke kapërcyer me çdo kusht besimet arkaike, bindjet hipersociale të së kaluarës, mentalitetet për fuqinë e ndikimit masiv edukativ të shoqërisë mbi njeriun. Koha që po jetojmë na ka vënë përballë shumë dilemave sociale, personale dhe edukative, të cilat mjaftojnë për të na bindur që të kuptojmë se po jetojmë “kohë të vështira” socio-edukative.

Çdo ditë e më shumë po përballemi me shfaqje, dukuri, sjellje dhe me fenomene sociale që jo vetëm janë shqetësuese në vetvete, por janë në të njëjtën kohë “tregues sintetikë” të situatës së anomisë dhe çorganizimit social që tani zhvillohet lirisht në shoqërinë shqiptare. Si kurrë më parë janë shtuar shqetësimet sociale, kaotizmi edukativ, sjelljet brutale dhe qëndrimet asociale të njerëzve dhe në të njëjtën kohë është dobësuar edhe “kontrolli social” i shoqërisë, si edhe “vetëpërmbajtja edukative” e njeriut.

Esenca e kësaj situatë është e lidhur organikisht dhe në mënyrë të natyrshme me raportet e reja të ndryshuara të cilat njerëzit i kanë ndërtuar me shoqërinë tonë. Shumë problematike po shfaqen marrëdhëniet e deformuara që burojnë nga shkëlja e logjikës sociale të raporteve demokratike midis lirisë së individit dhe përgjegjësisë sociale që duhet të ketë për sjelljen e tij individuale. Këtë problem të madh social nuk po e bëjmë dot ende problem të diskutimit sociologjik, pedagogjik dhe praktik.

Kjo meqë tradicionalisht e kemi parë si “çështje me vete”, si problem me natyrë edukative dhe morale duke e vlerësuar

më shumë si cilësi të jashtme të formës së sjelljes së njeriut. Ndoshta për shkak të ndikimeve të forta, që ka pasur në shoqërinë shqiptare pedagogjia formale, apo për arsye të besimit të tepruar për vlerësimin e ndikimit social edukativ të shoqërisë, çështjet e sjelljes akoma nuk i shikojmë aq sa duhet si çështje ontologjike të lidhura ngushtë, thelbësisht dhe në mënyrë të pazgjdhshme me thelbin e ndryshuar të njeriut modern, me ontologjinë dhe kuintesencën e personalitetit të tij.

Në kushtet e një shoqërie të lirë, në kohën e reduktimit të përshpejtuar të ndikimit edukativ të formave tradicionale sociale mbi natyrën e njeriut, jemi të detyruar që, për të pasur sukses në operacionin e përbashkët social për të “rregulluar shoqërinë”, na duhet të përmirësojmë “standardet e edukimit” dhe ndërtimin e “strukturës së re të sjelljes” qytetare të njerëzve tanë; së pari ato duhen parë më ndryshe. Kjo se te njeriu i sotëm me natyrë personale dhe sociale kontradiktore si dhe të ndërlikuar, nuk mund të ndikohet me standardet, me format dhe modulet e vjetra të edukimit dhe punës edukative dhe sepse duhet llogaritur që jo vetëm koha dhe “tereni edukativ” ka ndryshuar, por është “transformuar” dhe thelbi i natyrës së njeriut postmodern me të cilin bashkëjetojmë. Ato nuk janë më si kanë qenë më parë. Kjo do të thotë që kur planifikojmë që të edukojmë ose të përfshihemi në role edukatori, të bëjmë punë edukative në familje, shkollë, komunitet apo në institucione fetare duhet të llogaritim të vërtetën e ndryshuar, se në thelbin e sjelljes, në esencën dhe në format e sjelljes edukative njerëzit po shfaqen gjithnjë e më pak qenie sociale apo njerëz të qytetëruar me “dimension edukativ”.

Kjo dukuri nuk është vetëm e jona, por problem global për njerëzimin aktual. Ndoshta kjo është arsyeja pse filozofët,

sociologët, psikologët dhe pedagogët e kohës sonë flasin për një “shikim më ndryshe” të raportit të njeriut me shoqërinë dhe ndërgjegjen individuale, duke e parë si kusht fundamental për të pasur të garantuar koherencën edukative, unitetin e përbashkët të qenies dhe garantimin e strukturës kompakte të sjelljes personale si qytetar. Ndërtimi i strukturës së sjelljes së njeriut, situata e shfaqjes masive të njeriut pa “dimension edukativ” nuk është më aq shumë një proces social fatalisht i determinuar, apo një realitet që i imponohet atij tërësisht dhe mekanikisht nga jashtë, nga ndikimet dhe fuqia omnipotente e faktorit social.

Tani struktura dhe shfaqja e sjelljes së njerëzve në shoqëri është më shumë “çështje e brendshme” e formimit të personalitetit të tij, që ka të bëjë me mënyrën sesi i vendos njeriu raportet personale me ndërgjegjen e tij dhe të tjerët, nga forma që ai përdor për të ndërtuar “strukturën e sjelljes”, si sendërton formën e dukjes së individualitetit të tij të veçantë, si kompozon subjektivisht “invidiumin e papërsëritshëm”.

Me fjalë të tjera, kjo strukturë e ndërlikuar e sjelljes së njeriut nuk është dhe nuk duhet parë si një pasqyrim mekanik i dëshirave dhe parimeve morale të shoqërisë, por si produkt autentik, i veçantë, i përveçëm, që në një masë të konsiderueshme nuk është i lidhur shumë me “determinimet e jashtme” të shoqërisë sesa me “Odisenë e shpirtit” të njeriut konkret, me dëshirat dhe aftësinë e tij për të ndërtuar një “strukture personale” sjelljeje, e cila në çdo rast është në “lidhje sociale” me raportet që vendos në radhë të parë midis “vetes” dhe “ndërgjegjes” së tij.

Ky raport edukativ, i ndërtuar në mënyrë subjektive, është më shumë proces intim sepse njeriu i lirë duke qenë pa dimension të determinuar social dhe edukativ, është sovran në mënyrën si i ndërton raportet vetjake të sjelljes sociale, në

përputhje me nivelin dhe ndërgjegjen e tij. Duhet të kuptojmë, të pranojmë dhe të përshtatemi me të vërtetën se njerëzit tani dhe kurrë më pas, nuk shfaqen si “turma” të determinuara, me sjellje sociale të përbashkëta dhe të imponuara, por si njerëz të lirë, me “strukturë autentike” sjelljeje, me mënyra të veçanta të realizimit të moduleve të sjelljes qytetare.

Shkolla, familja dhe shoqëria civile

Në mendimin postmodern pedagogjik bashkëkohor theksohet me forcë dhe konsiderohet si inovacion fakti që në situatën sociale dhe në sjelljet e njeriut ka ndikim negativ të dukshëm ulja e rolit dhe e misionit tradicional të dy institucioneve kryesore të edukimit dhe sigurisë morale të shoqërisë, siç janë shkolla dhe familja. Natyrshëm ato kanë pësuar evolucion, kanë reflektuar ndryshimet e përshtatjes institucionale me nevojat sociale, me detyrat dhe me imperativët e shoqërisë në çdo kohë.

Nuk është as qëllimi as koha dhe vendi i duhur për të diskutuar problemet e brendshme të këtyre dy institucioneve, as për të bërë vlerësime gjithëpërfshirëse për raportin delikat, midis qëndrueshmërisë konservatore të tipologjisë institucionale të shkollës dhe familjes dhe fleksibilitetit temporal, midis natyrës konservatore dhe aftësive sociale adoptuese të tyre. Për kohën dhe mendimin postmodern bashkëkohor këto mbeten dy institucione edukative me vlerë të pazëvendësueshme, fundamentale, të cilat së bashku me shoqërinë civile përbëjnë “shtratin edukativ” social-pedagogjik, në të cilin njeriu, fëmija, nxënësi, prindi dhe mësuesi bëjnë “kalimin” të njëri-tjetri të traditës, kulturës, edukatës, kodeve morale të shoqërisë.

Në këtë “triadë” të institucioneve themeltare edukative, në domosdoshmërinë e lidhjes dhe të funksionimit sinkron të tyre, shpesh ka qëndrime metafizike e tradicionaliste, që vlerësojnë a mbivlerësojnë artificialisht njërin ose tjetrin institucion. Kjo ndarje mekanike, ky copëtim i roleve sintetike dhe sinkretike të shkollës dhe familjes, i lidhjes së tyre organike me shoqërinë civile, nuk është vetëm “handicap” teorik socio-pedagogjik, por mbi të gjitha është një non sens që sjell pasoja empirike në punën e interferuar të këtyre institucioneve bazë të shkollimit dhe edukimit, sepse ndan padrejtësisht rolet dhe përgjegjësitë që kanë këto hallka në procesin unik, afatgjatë, të veprimtarisë së integruar të familjes, të shkollës dhe shoqërisë civile për shkollimin, kulturimin dhe edukimin qytetar të nxënësit dhe studentit.

“Trekëndëshi i madh” i pazëvendësueshëm: familje, shkollë, shoqëri civile janë tri “leva të fuqishme” të ndikimit socio-edukativ dhe pedagogjiko-kulturor mbi të rinjtë, sidomos në periudhën e të nxënësimit intensiv përmes veprimit të menjëhershëm, të sinkronizuar dhe sintetizuar të edukimit përmes institucioneve të tilla si familja, shkolla dhe organizatat e ndryshme autoritare të shoqërisë civile.

Historia e shoqërisë, e shkollës dhe e familjes shqiptare ka vërtetuar tashmë në mënyrë të padyshimtë, se askush nga këto institucione të rëndësishme veç e veç pa veprim të integruar, të shkëputur nga njëri- tjetri nuk mund të japë efektet e dëshiruara edukative. As familja e shkëputur nga shkolla, por as shkolla e ndarë nga familja, dhe të dyja së bashku të veçuara nga shoqëria civile nuk mund të kenë aftësi edukuese çudibërëse.

Nëse duam që të rritim efikasitetin dhe efikasitetin e këtyre institucioneve, “sui generis” edukative në shoqëri, duhet të gjejmë dhe të vëmë sa më parë në zbatim “formulën”

e veprimit të sinkronizuar të familjes, të shkollës dhe të shoqërisë civile, për të “rindërtuar” atë mekanizëm që forcon ndikimin e pamjaftueshëm që vjen nga “kapacitetet e veçuara”, nga separatizmi edukativ i veprimtarisë pa lidhje vepruese organike të familjes, shkollës dhe të shoqërisë civile.

Kjo lidhje institucionale në shoqërinë tonë është dobësuar shumë dhe pasojat edukative janë evidente. Dobësimi i strukturës së brendshme të familjes, cenimi i autoritetit pedagogjik e institucional të shkollës, si edhe roli i zbehtë social i shoqërisë civile, janë probleme të mëdha ekzistenciale dhe fundamentale, jo vetëm për shoqërinë shqiptare në tërësi, por veçanërisht për këto institucione edukative, për punën, për rolin dhe autoritetin e tyre institucional që ende te ne është e pasinkronizuar.

Ne jemi në një situatë në të cilën evidentohen qartë “veprimet e përçara”, të shkëputura, të pasinkronizuara me njëra-tjetrën të shkollës, familjes dhe shoqërisë civile. Në këto kushte jemi të detyruar të reflektojmë duke kuptuar dëmet e mëdha socio-edukative që kemi, vështirësitë që hasim në punën e familjes, shkollës dhe shoqërisë për shkak të mungesës së veprimit të sinkronizuar institucional, të punës së përbashkët të tyre për të sjellë pasoja pozitive mësimore, edukative dhe sociale.

Në këtë “triadë” të institucioneve bazë të edukimit të njeriut në realitetin shqiptar, duket se më i zbehtë është kontributi i shoqërisë civile. Pa dyshim, shoqëria civile është më pas në dhënien e kontributit të vet i cili pa e mbivlerësuar, ekzagjeruar apo hiperbolizuar duhet pohuar se ka forcë të veçantë ndikuese, formuese dhe transformuese me “natyrë kolektive”. Por kjo epërsi e saj në vetvete nuk ka vlerë, nëse nuk “rrjedh” nëpër kapilarët e natyrshëm edukativë të shkollës

dhe familjes. Këtë epërsi, të shoqërisë civile, në raport me shkollën dhe familjen, askush nuk e vë në dyshim. Filozofët, sociologët dhe pedagogët e kohës sonë e kanë evidentuar me përparësi këtë fakt, i cili tashmë është i provuar edhe në shoqërinë shqiptare.

Shoqëria civile përmes komponentëve dhe strukturave përbërëse të saj, ka aftësi të prodhojë ide, koncepte, praktika të mira dhe realitete sociale të cilat kanë efekt edukativ pozitiv në shoqëri, në ndryshimin dhe transformimin e mentaliteteve, kodeve morale dhe të sjelljes së njerëzve brenda saj. Ndërkaq problemi tashmë duhet parë edhe në një prizëm të ri të ndikimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pedagogjik të shoqërisë civile, të lidhjes së saj korelative me shkollën si institucion.

Duhet që në politikat arsimore dhe në veprimtarinë e shkollës, të mësuesve dhe nxënësve të rivlerësohet lidhja e ngushtë, organike, permanente si institucion me shoqërinë civile, e cila nga ana e vet ka forcë të konsiderueshme që të ndikojë mbi shkollën dhe familjen. Ato duhet të dinë të “përfitojnë dhe shfrytëzojnë” potencialin transformues, masiv të shoqërisë civile për të ndryshuar tradita, ide, kode morale dhe shpirtërore, koncepte e praktika të ngulitura, të cilat janë me peshë fundamentale për institucione të tilla unikale, me forcë ndikuese të veçantë siç janë shkolla dhe familja.

Ndërkaq, ndikimi i shkollës dhe i familjes ndaj shoqërisë civile, nuk është pasiv, i pavlefshëm. Nëse do të shikojmë realitetet tona, duhet të pohojmë se shkolla dhe familja kanë rol të rëndësishëm dhe kanë mundësi të japin një kontribut të dukshëm në ndërtimin e shoqërisë civile në Shqipëri. Në këtë kontekst, familja dhe shkolla duhet ta shikojnë veten jo

vetëm në rolin “reflektues” ndaj vlerave që kultivon shoqëria civile shqiptare, por dhe të ndikimit që ato kanë në ndërtimin e shoqërisë civile, e cila asnjëherë nuk mund të realizohet me sukses si proces social, nëse nga familja dhe shkolla nuk dalin qytetarë, të cilët janë “lënda e parë” që duhet për ndërtimin e shoqërisë civile.

Koha kërkon që këtë moment shkolla dhe familja ta vlerësojë më shumë se kurrë sepse është historikisht e njohur, e pranuar dhe e konfirmuar roli i veçantë, i këtyre dy “institucioneve konservative”, të qëndrueshme, mbi kulturën, traditat, zakonet dhe sjelljet sociale të individit. Gjurmët e edukimit që burojnë nga modeli dhe nga tipologjia e këtyre institucioneve janë tepër të forta, rezistente, të vështira për t’u ndryshuar e transformuar. Në vendin tonë shteti, shoqëria, familja dhe individi tradicionalisht për këto dy institucione, sidomos për shkollën ka vlerësim të veçantë, respekt të merituar, në veçanti për forcën e tyre formuese apo pse jo edhe deformuese.

Nuk është konservator mentaliteti social i shoqërisë shqiptare që edhe sot, me gjithë peripecitë që po kalojnë këto dy institucione, përgjithësisht shkolla dhe familja mbeten të vlerësuara, të pazëvendësueshme për “krijimin e botëkuptimit” të individit.

Ato mund dhe duhet të ndikojnë në forcimin e shoqërisë civile duke vënë në përdorim mjetet e tyre specifike, duke luftuar deformacione sociale të trashëguara, tiparet individuale të karakterit dhe personalitetit të njeriut, të cilat e bëjnë të vështirë procesin e krijimit të shoqërisë civile. Familja dhe shkolla janë instrumente që ndikojnë për të ndërtuar relacione të reja, për të prodhuar “kapital social” si vlerë e madhe e shoqërisë funksionuese demokratike.

Sa më shumë të vonohemi në kuptimin e vlerës që kanë transformimi i ideve, institucioneve bazë të formimit të individit si familja dhe shkolla, aq më shumë do të jemi të penguar e të vonuar në rrugën e vështirë të ndërtimit të shoqërisë demokratike, të relacioneve qytetare ekuivalente me ato europiane. Mungesa e vëmendjes në procesin e transformimit të familjes dhe shkollës sonë, përbën pengesën, ndoshta më të madhe në kultivimin e vlerave të reja, për të cilat ka nevojë modelimi dhe funksionimi i shoqërisë sonë.

Këto lidhje reciprokisht ndikuese, me sens pozitiv apo negativ të familjes, shkollës dhe shoqërisë duhet të jenë të vlerësuara, në qendër të vëmendjes së punës së mësuesve, prindërve, nxënësve. Formatimi i shoqërisë civile në vendin tonë nuk mund të kuptohet apo të realizohet, pa ndikimin esencial në këtë proces të familjes si qelizë e shoqërisë dhe shkollës si institucion socio-pedagogjik. Ky relacion relevant i këtyre institucioneve është “triunivok”, me ndikim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë mbi njëri-tjetrin.

Në këtë sfidë të re ne kemi problemet tona, kemi traditën, të kaluarën historike e politike, nivelin e zhvillimit të institucioneve publike e private të edukimit. Bashkë me to kemi si pengesë serioze një gjendje përgjithësisht kaotike të shoqërisë. Shkolla ndërkaq është në reformim dhe natyrisht ka problemet e veta në rrugën e modernizimit të saj. Familja shqiptare “lëkundet” në valët e një procesi kontradiktor, duke i reduktuar funksionet edukative, duke përqendruar në mënyrë të njëanshme forcat dhe resurset kryesore në garantimin e kushteve të ekzistencës, të mirëqenies së pjesëtarëve të saj. Nuk është fare pozitive situata që dëmton idenë se ka rënë vlera e familjes dhe e shkollës si institucione, që mund të ndikojnë

dhe të ndryshojnë modelet e vjetra të sjelljes së individit, në procesin e vështirë të kalimit nga “njeri në qytetar” nga “nënshtetas në individ social”.

Procesi i transformimit social, kalimi i shoqërisë shqiptare nga situata e kaosit paradoksal, në modelin vetorganizues, komunitar të shoqërisë civile, nuk mund të bëhet pa nxitur procesin paralel dhe të integruar të transformimit qytetar të familjes, shkollës dhe individit. Nuk ka ndryshuar bindja se njeriu si qenie mund të kultivohet pozitivisht në familje dhe në shkollë, në këto dy institucione fundamentale të formimit në të cilat formatohet qytetari i kultivuar, që është “tulla e parë” e shoqërisë civile. Shoqëria civile nuk është bashkim rastësor njerëzish, që mblidhen pa pasur lidhje dhe kohezion social.

Një bashkim i tillë, është provuar që nuk sjell vlera, ide e transformim social pozitiv, nuk mund të krijohet pa kontributin e përbashkët të familjes dhe shkollës. Familja, shkolla shqiptare, në bashkëpunim me organizimet e shoqërisë civile, me grupet e interesit, me shoqatat, organizatat jofitimprurëse dhe joqeveritare, institucionet e besimit fetar me fjalë të tjera, të gjithë “repartet e organizuara” të shoqërisë sonë duhet të tregojnë vendosmëri konstante, në drejtim të kultivimit të mënyrës së jetesës qytetare. Mënyra e jetesës, përmirësimi i sjelljes së njerëzve në shoqëri, është bërë detyrë e parë, objekt me rëndësi të veçantë për to.

Ndërkaq, procesi pozitiv i zhvillimit të formimit të shoqërisë civile dhe i formimit qytetar të individit, korrigjimi i defekteve psikosociale dhe etike, të lindura apo të trashëguara nga familja, apo të ndikuara nga shkolla dhe shoqëria e vjetër në të cilën kemi jetuar (dhe ky nuk është absolutisht faji ynë) është detyrë e madhe, e rëndësishme për të gjitha strukturat

e tjera të shoqërisë civile. Një lidhje e re dhe e fortë midis familjes, shkollës dhe shoqërisë civile, është garanci morale e ndërtimit të qytetërimit tonë modern me standarde europiane.

Familja, shkolla dhe shoqëria civile janë struktura “të dënuara” që të punojnë sinkron, në lidhje korrelative duke bashkuar kontributet specifike, në ravijëzimin e vlerave dhe tipareve të qytetërimit tonë. Pa këtë lidhje, është e vështirë të priten rezultatet e dëshiruara në procesin e ndërtimit të qytetërimit tonë.

Karrierë për të talentuarit apo për të gjithë?

Në të vërtetë për shoqërinë tonë kjo është thirrje e re, por jo për të tjerët, që kanë kohë që i kanë përcaktuar kriteret dhe modalitetet e karrierës sipas vlerës personale dhe nevojave të zhvillimit social. Bota ka pothuaj 200 vjet, që kur u shfaq shoqëria moderne, si shoqëri e bazuar në lirinë e shanseve dhe në kompeticionin e aftësive individuale, që e përdor përgjithësisht me sukses këtë mekanizëm.

Në momentin që popujt europianë dhe amerikanë filluan rrugën e modernitetit dhe kuptuan vlerën nxitëse të lirisë, forcën e dijes, nuk i janë larguar për asnjë çast vlerësimit meritokratik të njeriut dhe pozitës sociale të tij. Francezët, tre shekuj më parë, mbushën muret e qyteteve të Francës me frazën mobilizuese “la carriere ouverte aux talents”.

Më duket se ne pas devijimit të llahtarshëm antihistorik të periudhës së komunizmit dhe hallakatjes së gjatë të tranzicionit, jemi në momente të rëndësishme, që mbase duhet të kujtojmë rrugën nga e kanë nisur popujt e qytetëruar zhvillimin e tyre të

suksesshëm. Ndoshta, ngaqë në këto momente në vendin tonë është rritur, si asnjëherë më parë, sensibiliteti për shkollën, për cilësinë e shkollimit dhe të arsimimit.

Disa vite më parë, në kohën e “marrëzisë kolektive” të piramidave dhe të një vaniteti social të përgjithshëm provizor, u krijua një përjetim social mediokër gati i shtrembëruar, se shkolla është hiç përballë pasurisë dhe parasë e cila vihet edhe në rrugë që nuk kalojnë nga shkolla, karriera dhe aftësitë e njeriut. Por për fat të mirë kjo epidemi e rikthimit të injorancës mesjetare kaloi shpejt dhe njerëzit, të rinjtë dhe prindërit e tyre i janë kthyer me intensitet të ri shkollës dhe shkollimit, ndoshta si asnjëherë më parë.

Mjafton të shikoni se çfarë presioni po pëson arsimi i lartë për të zgjeruar aftësitë përthithëse të sa më shumë të rinjve, për të kuptuar se ka filluar një “erë e re” në arsimin tonë kombëtar. Pa dyshim, në këtë aspekt kanë meritën e pamohueshme reformat e drejta, nxitëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit drejtuesit e së cilës, kanë meritën jo vetëm konceptuale, por dhe implementuese për kultivimit të standardeve të reja në këtë fushë të gjerë me të cilin është e lidhur e sotmja dhe e ardhmja e vendit tonë.

Shoqëria shqiptare është e “detyruar” që të krijojë mundësi dhe shanse të barabarta për të gjithë të rinjtë që kanë dëshirë për shkollim. Por kjo nuk do të thotë se edhe përfitimet në jetë të të shkolluarve do të jenë të barabarta për të gjithë, pavarësisht nga cilësia e shkollimit. Pabarazia materiale, që është e lidhur me “sasinë dhe cilësinë” e shkollimit, është “pabarazi e shëndoshë”, që vetë shoqëria moderne e ka gjetur si mjet të vlerësimit të kontributit social të secilit. Natyrisht të lidhur edhe me cilësinë e shkollimit dhe të performancës së individit.

Nuk është shoqëri moderne ajo që nuk sjell fitime të pabarabarta për njerëz që kanë kapacitete të ndryshme, nivel dhe cilësi arsimimi të ndryshme. Pa dyshim, në këtë realitet ka një varg faktorësh të ndërlikuar, me efekt të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në shkollimin e të rinjve tanë, që lidhen jo vetëm dhe thjesht me aftësitë dhe kapacitetet e tyre individuale, por dhe me aftësitë materiale të trashëguara të familjes, të cilat në shumë raste kthehen në faktor komplementar shtesë, në startin e diferencuar për fëmijët e tyre, që të sigurojnë nivele të larta arsimimi të vazhdueshëm cilësor, i cili natyrisht qoftë edhe për këtë shkak, bëhet më i favorizuar në tregun e punës dhe në karrierë.

Shoqëria jonë nuk ka rrugë tjetër, por edhe ato më të zhvilluarat nuk janë në gjendje të realizojnë barazi të plotë në shkollim, e cila jo vetëm nuk është demokratike, por edhe cenon rëndë lirinë e zgjedhjes së shansit sipas mundësive të individit, kapitalit të tij intelektual dhe shfrytëzimit të kapitalit familjar si “epërsi e trashëguar”.

Në kohën tonë është e pamundur të konceptohet ekzistenca e një shoqërie që të mund të sjellë barazi në shkollim. Natyrisht është ndonjëherë e dhimbshme që rastësia, që i ka kaluar disa epërsi të tilla, të disa njerëz që nuk janë në gjendje që t’i shfrytëzojnë ato si epërsi për nivele më të larta cilësore shkollimi dhe që nuk janë më pas në gjendje që investimin e bërë ta kthejnë në vlerë shoqërore, siç mund ta bëjnë disa të tjerë që nuk patën shanset e tyre të trashëguara.

Në shoqërinë tonë, tani si asnjëherë më parë, janë në provë politikat e shtetit për arsimin. Në këtë moment duket se është në rrugë të mbarë zgjidhja e raportit midis barazisë së shanseve të barabarta të shkollimit sipas aftësisë së testuar (praktika e maturës shtetërore po shfaqet e suksesshme), zgjerimit të

mundësive të shkollimit dhe nevojës së një politike orientuese dhe imponuese arsimore të shtetit. Në tërësinë e vet kjo është politika arsimore që krijon mundësi për të rinjtë që të mund të shkollohen intensivisht, si kusht themelor për të pasur karrierë profesionale të suksesshme.

Natyrisht, pas këtij hapi të parë të suksesshëm shoqëria jonë duhet të bëhet gati që pa sentimentalizëm social, pa mëdyshje, nepotizëm dhe afeksione politike të hapë rrugën e karrierës për të talentuarit. Këtu kemi me të vërtetë probleme që e zhvleftësojnë në shumë raste punën e të rinjve për të akumuluar dije, njohuri shprehi e shkathtësi me intensitet të veçantë përmes arsimit të vazhdueshëm. Kjo është detyrë imperative e përputhjes së politikave arsimore, të përgatitjes së një brezi të rinjsh, shumë të talentuar me politikën shtetërore të “karrierës së hapur” me përparësi për ta, sidomos në administratën publike, në të cilën asgjë nuk e kufizon dorën përzgjedhëse të shtetit.

Në këto momente, besoj se është koha që të bëjmë atë që kanë bërë vende dhe popuj të tjerë në kohën dhe vendin e duhur, duke hapur karrierën për njerëzit e talentuar, duke kufizuar politikat sasiore, të mbajtjes së një numri të panevojshëm nëpunësish, duke mos frenuar tendencën e vjetër të ekstensivitetit dhe plagës së vjetër të trajtimeve me preferenca militantiste. Ka ardhur koha që nuk do të ecim dot më tej me ritmin që kërkohet, po qe se nuk i japim fund “iluzioneve të aftësive të barabarta” dhe të padiferencuara të njerëzve tanë, sipas aftësive të tyre të konfirmuara në shkollë dhe në jetë.

Politika dhe nivelet e arsimimit në vendin tonë duket se janë më progresive dhe më të shpejta sesa politikat e zbatimit të kritereve meritokratike të karrierës personale. Pa këtë të fundit,

është e vështirë që më pas arsimit të mbajë të ngritur kurbën e interesit të rinjve tanë për shkollim. Duhet të largojmë sa më shpejt të kemi mundësi, pengesat për njerëzit e aftë e të talentuar. Veçanërisht shfaqjet e privilegjeve në punësim, për shkaqe që nuk janë në lidhje të drejtpërdrejtë me cilësitë e kandidatëve, por me pasurinë e familjes së tyre, me trafikun e influencave politike dhe nepotike, të cilat deformojnë rëndë politikën arsimore, mundësitë e hapura dhe të barabarta për karrierë për të gjithë sipas aftësive të tyre.

Shteti nuk ka detyrë, të japë nivele të barabarta arsimimi dhe as të gjejë punë të barabarta për të gjithë. Në shoqërinë tonë është e pamundur që të rinjtë të kenë start nisjeje, mundësi pasurore e zgjedhjeje, për të siguruar arsim të barabartë. Në kushtet e shoqërisë demokratike kushtet familjare dhe personale janë të ndryshme dhe niveli i shkollimit individual shfaqet natyrshëm plotësisht i ndryshëm. Por shteti duhet të jetë instrument i vlerësimit të barabartë, për të evidentuar aftësitë e pabarabarta të njerëzve për të kapur të njëjtin nivel karriere.

Vendosja e kushteve të barabarta për konkurrin të drejtë sipas vlerave personale, pavarësisht faktorëve të tjerë ekstra arsimorë, të lindur, të trashëguar, gjenetikë apo rastësorë politikë është konditë demokratike edhe për arsimimin e njerëzve. Kjo po, është detyrë dhe ekskluzivitet i politikave shtetërore.

Nuk ka dyshim që një pjesë e madhe e politikës së “karrierës së hapur për të talentuarit” është në dorën përzgjedhëse të shtetit, të rrethanave që ai krijon për kredibilitet konkurrues. Politika arsimore duke u bashkuar me politikën e vërtetë të shanseve të barabarta dhe

perspektivës së njëjtë për të talentuarit, do t'i bëjë një shërbim shumë të madh zhvillimit tonë kombëtar, rikthimit të besimit të tronditur të rinjve se edhe vendi ynë i ka të gjitha shanset që të bëhet si të gjithë të tjerët. Veçse duke e shkruar seriozisht, jo në mure si francezët natyrisht, por në mendjen politike: “la carrier aux talents”.

Kohë e vështirë për prindërit dhe mësuesit

Shkolla dhe familja shqiptare janë bërë sot dy nga institucionet më problematike. Natyrisht, për shkak të marrëdhënieve gjithnjë e më të vështira të “aktorëve” kryesorë përbërës të tyre, adoleshentët nga njëra anë dhe prindërit dhe mësuesi nga ana tjetër. Kurba e konfliktit midis tyre ka tendencë të rritet, madje duke marrë shpesh edhe pamje agresive. Ndërkaq duket se këto institucione janë në vështirësinë e njohur, të mospërputhjes midis ndryshimit që ka pësuar si tipologji shkolla dhe familja me mënyrën e vjetër të perceptimit të autoritetit të babait, nënës dhe mësuesit.

Kjo krizë në ditët tona, në shkolla dhe në familjet tona ka prirje agravimi, për shkak se kanë ndodhur ndryshime të mëdha, por që kalojnë në “kahun e kundërt” të modelit të vjetër të pushtetit autoritarist të prindërve dhe mësuesve. Këtu është baza e situatave të shumta konfliktuale të cilat ndeshen përditë. Ky është shkaku që edhe fëmijët ankohen për mësuesit dhe prindërit e tyre, por dhe këta të fundit janë të shqetësuar për qëndrimin “kryengritës” dhe mosbindës të adoleshentëve. Nuk ka shkollë dhe familje shqiptare që të mos i ketë këto probleme. Cilat janë shkaqet dhe si mund të zbuten këto konflikte?

Në shoqërinë shqiptare postmoderne kanë ndryshuar shumë relacione klasike tradicionale, janë thyer “tabutë” që kanë qenë të kristalizuara në shekuj në marrëdhëniet midis njerëzve, brezave dhe profesioneve. Sidomos në marrëdhëniet që kanë të bëjnë midis adoleshentit, prindërit dhe mësuesit. Në njëfarë mënyre në çdo kohë ato aq sa kanë qenë marrëdhënie të “mbyllura institucionale” po aq kanë qenë të varura, pse jo edhe të përcaktuara nga niveli i zhvillimit moral dhe social të shoqërisë tonë.

“Kurba” e këtyre marrëdhënieve, asnjëherë nuk ka qenë konstante, e pandryshuar. Përkundrazi dinamika e marrëdhënies dhe e “konfliktit të paralajmëruar” midis prindërit dhe mësuesit nga njëra anë, dhe adoleshentit nga ana tjetër, ka qenë dhe mbetet një nga pikat e vjetra kritike. Ka qenë dhe mbetet pozitiv fakti që në traditën tonë edukative kombëtare, prindi dhe mësuesi kanë qenë pa dyshim ndër figurat me autoritet të padiskutueshëm. Në trashëgiminë dhe në traditën tonë edukative ata kanë pasur rol parësor në ndërtimin e themelit edukativ të fëmijës dhe adoleshentit. Prindi dhe mësuesi kanë qenë figura të pranuar dhe të pakontestuara nga shoqëria jonë.

Sociologu, Erich Fromm, ka të drejtë kur në analizën e tij thekson se këto dy figura edukative kanë pasur autoritetin më të madh dhe të padiskutuar në të gjithë shoqëritë. Madje, në përpjekjen e tij për të gjetur një figurë tjetër ekuivalente për nga autoriteti psikosocial, ka thënë se mbi autoritetin e mësuesit dhe prindit kanë qenë vetëm klerikët. Mbiqendrimi i rolit edukativ të prindërve dhe mësuesit në shoqërinë shqiptare, ka qenë jo vetëm pjesë e traditës dhe e mekanizmit edukativ të skalitur në shekuj.

Realisht për një periudhë gjysmë shekullore, ky autoritet u bë pjesë e “mekanizmit” të shoqërisë totalitare e cila këto dy figura i manipuloi dhe i vendosi në “shërbimin shtesë” për ruajtjen e autoritetit politik të shtetit. Ndaj shoqëria totalitare, shkolla dhe familja patriarkale nuk mund të funksiononin pa autoritetin e pacenuar absolut të mësuesit në shkollë dhe prindërit në shtëpi. Pa këto figura do të ishte i vështirë ushtrimi i dogmës ideologjike dhe edukimi i të rinjve me tabu dhe gënjeshtër.

Mirëpo tani koha ka ndryshuar dhe relacionet edukative nuk janë më si më parë. Në disa drejtime kanë ndodhur përmbyse që kanë krijuar ndjenjë skepticizmi dhe mosbesimi për rolin dhe aftësitë edukative të prindërit dhe mësuesit. Shoqëria jonë po modernizohet, bashkë me pasojat e mira dhe të këqija që natyrshëm shoqërojnë këtë proces. Ajo po kalon krizat e natyrshme të “adoptimit” me parimet e lirisë, individualizmit, ndaj është e vështirë që autoriteti i dikurshëm i mësuesit dhe prindërit të jetë në të njëjtën formë dhe nivel.

Kanë ndryshuar shumë gjëra. Familja dhe shkolla nuk janë më ato që kanë qenë as si institucion social dhe edukativ, por as të rinjtë nuk janë më ata që kanë qenë në të kaluarën. Principet e ndryshuara dhe të demokratizuara të familjes dhe shkollës kanë krijuar një situatë të re e cila nga moskuptimi, konservatorizmi dhe recidivat e sjelljes autoritariste të mësuesit në shkollë dhe prindërit në familje, shpesh sjellin konflikte, ashpërsi, brutalitet, vrazhdësi. Nëse do të përpiqemi që të gjejmë shkaqet e kësaj dukurie, “krizës së autoritetit” të nënave, baballarëve dhe të mësuesve do të thosha se me siguri është i dyanshëm.

Pedagogët dhe sociologët thonë se në çdo rast kur ka “konflikt”, madje edhe “kur bëhet dashuri” duhen të paktën dy vetë, që të kenë marrëdhënie midis tyre. Në këtë kontekst duket se faji është i dyanshëm. Megjithatë, jo për oportunitet sociologjik, as për të mbajtur anën e të rinjve, duket se shkak kryesor i “krizës së marrëdhënieve edukative” të mësuesit dhe prindërit me adoleshentët është më së shumti në anën e tyre.

Diferenca moshore, mungesa e njohurive për veçoritë e reja moshore të zhvillimit të akseleruar fizik, psikik, emocional dhe seksual bëhet shpesh shkak i konfliktit. Ajo vjen ndërkaq prej njohurive të kufizuara nga mënyra e vjetër klasike autoritariste e ushtrimit të “pushtetit edukativ” të mësuesit në shkollë dhe prindërit në familje. Në të vërtetë kjo krizë është e thellë, është ekzistenciale dhe duhet kuptuar në të gjithë kompleksitetin e vet, për të shmangur ato që po ndodhin në shkollë dhe në familje midis mësuesit dhe nxënësit, fëmijës dhe prindërit. Madje ka momente që niveli i agresivitetit fillon verbalisht, dhe pastaj kalon në dhunë fizike e cila në jo pak raste ka sjellë konflikte me pasoja tragjike.

Më ka rënë rasti që të bisedoj me nxënës dhe me studentë, kur kam zhvilluar me ta leksione psiko-edukative, që të mësoj realisht të vërtetën e mendimit dhe vlerësimit të tyre për prindërit dhe mësuesit. Madje edhe për shkaqet kryesore të krijimit në jo pak raste të marrëdhënieve konfliktuale. Pjesa më e madhe e adoleshentëve dhe të rinjve, fajin e krijimit të “situatës konfliktuale” e hedhin mbi prindërit dhe mësuesit. Sipas tyre konflikti vjen si pasojë e mungesës së taktit të ndërhyrjes, përdorimit pa kriter të epiteteve ofenduese, në përpjekjet frenetike të prindit dhe mësuesit për të ndërhyrë më

shumë sesa duhet në jetën personale, për të mësuar gjëra sekrete të jetës intime përmes kontrollit patologjik të gjithçkaje.

Kjo tendencë është e papranueshme për të rinjtë, të cilët këtë “të drejtë” të prindit ose të mësuesit për të ndërhyrë më shumë sesa duhet në jetën personale, e quajnë të papranueshme, inkuizitive, agresive, cenuese të të drejtave dhe lirive të tyre. Natyrisht, shpesh në gjykimet e të rinjve ka dhe vlerësime ekstremalisht ekscentrike. Jo pak prej tyre janë të mendimit se, “koha i ka lënë pas prindërit dhe mësuesit”, se ata nuk i vlerësojnë ndryshimet që kanë ndodhur në kohën postmoderne, nuk janë në gjendje të kuptojnë dhe të interpretojnë raportet e reja njerëzore, të “drejtën e tyre të kufizuar” tashmë, mbi personalitetin e fëmijës si “nxënës” apo si “fëmijë”.

Kjo ka bërë që të ndihet një situatë disi paradoksale, që shfaqet si tendencë për të mos iu bindur mësuesit në shkollë dhe prindërit në shtëpi me argumentin që përdorin rëndom adoleshentët, se prindërit dhe mësuesit e tyre nuk kuptojnë asgjë, flasin gjëra të kota, merren me llafe boshe pa vlerë për jetën e të rinjve. Sipas tyre, të rinjtë nuk kanë më aq shumë nevojë për këshillat pa fund të tyre, se ata janë vetë në gjendje të përcaktojnë, të gjejnë dhe të realizojnë rrugën e jetës dhe lumturinë e tyre.

Sigurisht një situatë e tillë konfliktuale, midis adoleshentëve dhe prindërve dhe mësuesve të tyre nuk është normale. Megjithatë nëse duam të përmirësohen këto marrëdhënie, nëse duhet të zbutim konfliktet që krijohen në marrëdhëniet e tyre bilaterale, më së pari sipas mendimit tim, duhet të reflektojnë prindërit dhe mësuesit, duke u adoptuar me kohën, ndryshimet dhe zhvillimin e përshpejtuar të adoleshentëve. Kjo do të thotë, që ata duhet të kuptojnë se edukimi nuk bëhet më përmes “pushtetit autoritarist” dhe paternalist mbi fëmijët.

Nëse bisedon me adoleshentët ata pikërisht këtë “pushtet paternalist” të prindërit dhe mësuesit e urrejnë më shumë se çdo gjë tjetër. Ata nuk pranojnë më nënshtrimin ndaj ideve të vjetra, edukatës dhe këshillave boshe, moralizuese, bajate. Nëse duam të rregullojmë këto marrëdhënie, të cilat në thelb, për sa i përket pikëpamjes sociale, janë marrëdhënie brezash, duhet të ndryshojmë “instrumentet” e edukimit familjar dhe pedagogjik. Mësuesi dhe prindi pavarësisht nga “ndryshimi i kohës, janë dhe mbeten figurat kryesore të pazëvendësueshme, që kanë rol veçanërisht të madh ndikues mbi fëmijët në të dyja institucionet më kryesore me mision dhe funksion edukativ eksplicit, siç janë familja dhe shkolla.

Këto institucione nuk janë vjetruar, nuk janë bërë të panevojshme për të luajtur rolin e tyre të edukimit dhe formimit. Por ato po kalojnë “krizën e rritjes”, të transformimit të tyre tipologjik e cila nuk është e lidhur me faktorin ekzistencial, por me atë moral. Në këtë kontekst duhet shumë punë, mund, veprim energjik, kërkesë llogarie, tolerancë, koncepte të reja morale për t’i kuptuar të rinjtë, kërkesat, përjetimet e tyre emocionale, psikologjike dhe seksuale. Mbi ta, nuk mund të ndikohet me “instrumentet e ndryshkura” të shkollës së vjetër dhe me paradigmat morale të familjes patriarkale. Nëse ndryshojnë më së pari prindërit dhe mësuesit, kjo do të ishte garancia për shmangien e konflikteve të panevojshëm me adoleshentët.

Jeta urbane dhe “revolucionit edukativ”

Në kohën moderne është bërë shumë e vështirë të kërkosh nga njerëzit që të shfaqen në shoqëri me sjellje personale dhe

veprime sociale shoqërisht të “disiplinuara” deri në instancë të fundit. Këtë të vërtetë po e ndiejmë gjithnjë e më shumë në jetën e shoqërisë, familjes, shkollës, në jetën publike dhe botën e punës, sepse këto mjedise sociale tani konceptohen më shumë individualisht dhe këqyren me optika më të lira nga njerëzit dhe nga pikëpamja e mënyrës së jetesës ato po bëhen më të hapura dhe në këndshikimin e marrëdhënieve me të tjerët janë tashmë mjedise më të demokratizuara.

Në këtë kontekst sjelljet dhe qëndrimet morale të njerëzve tanë janë bërë më pluraliste, të papërcaktuara, sepse liritë individuale dhe papërgjegjshmëritë sociale janë zgjeruar aq shumë, sa që në jetën tonë të përditshme kanë sjellë paqartësi, keqkuptime të shfaqura si pakënaqësi sociale në familje, në punë, në jetën komunitare dhe në mjedise shoqërore.

Edukata, procesi i edukimit dhe nevojat e veçanta, që ndihen në shoqërinë tonë, për konceptim të ri të punës edukative, të zhvilluar me stil të ri në institucionet e edukimit social, formal dhe informal tregojnë se ende “sendet” në këtë fushë delikate nuk janë vendosur në vendin e duhur. Madje për shkak të “devijimit ultramaterialist” që ka marrë jeta jonë, çështjet e sjelljet dhe “individualizimi i etikës” për fat të keq nuk kanë arritur të jenë në qendër të debatit publik, kulturor, etik, pedagogjik dhe mediatik.

Duket sikur njerëzit tanë kanë mbyllur “veshët sociale” dhe kanë lënë të hapur vetëm një rrugë të komunikimit me shoqërinë: atë të dëshirave dhe halleve materiale, duke u bërë të obseduar pas nevojës për mirëqenie dhe konsum. Shoqërisht, sipas mendimit tim jemi në fazën e rrezikshme që do të këtë në shoqërinë tonë pasoja socialedukative, për shkak të neglizhimit fatal të kësaj pjesë që është me rëndësi

në ndërtimin e jetës qytetare dhe në plotësimin e standardeve të qytetërimit tonë modern. Përshtatja pasive me këtë situatë, është shkak për në shoqërinë shqiptare çështjet e edukimit tani nuk janë më probleme me rëndësi të veçantë.

Duke e vlerësuar situatën morale dhe devijimet e sjelljeve njerëzore, duhet të pranojmë se ato tashmë janë bërë problem serioze me impakt të gjerë dhe serioz për të sotmen dhe për të ardhmen e qytetërimit tonë. Çështjet e edukimit, edukatës dhe sjelljes së njerëzve po të vlerësohen me realizëm janë në një pikë kruciale shumë të vështirë. Nuk është normale që çështjet e sjelljes dhe problemet e sjelljes moralë të njerëzve tanë, të konsiderohen me mendjelehtësi sociale si “probleme periferike” të shoqërisë, apo si çështje lineare, që rrjedhin natyrshëm në “rrugën e tyre”, dhe që më pas është koha ajo që “i zgjidh vetë” në rrugë spontane. Është ky mentalitet joqytetëruar që ndikon në faktin se në shoqërinë tonë, ndërsa problemet e sjelljeve joqytetare janë agravuar, ato ende nuk kanë marrë rëndësinë e tyre, nuk janë bërë probleme qytetare, nuk konsiderohen si çështje me vlerë për të ardhmen e shoqërisë dhe qytetërimit tonë.

Në të vërtetë çështjet e jetës morale dhe veçanërisht problematikat e mprehta të sjelljeve të shumta me natyrë asociale, që shfaqen në jetën publike dhe private të qytetarit, ka bërë që tashmë të kemi një deformim social të dukshëm, prishje progresive të mjedisit etik në shoqërinë tonë. Ato tashmë jo vetëm janë bërë me peshë ndikuese, por po bëhen edhe të vështira për t’u zgjidhur në rrugën e duhur, sepse ndodhemi në një moment kur etika, edukata, edukimi dhe atmosfera edukative janë nën goditjet e forta, shkatërruese, të padrejta të cilat jo vetëm zhvillohen në sytë tanë, por dhe

frymëzohen nga keqkuptimet socioetike dhe filozofike të perceptimit të deformuar të hapësirës së lirisë, të së drejtës së individit për sjellje personale.

Është vështirë të dallosh nga pikëpamja etike sjelljet dhe qëndrimet e “lejuara” nga ato të “palejueshme”. Deformimi i këtij raporti në shoqërinë tonë nuk është më fenomen sporadik, por është bërë fenomen social i përditshëm, masiv, shqetësues. Të gjithë e ndiejmë këtë shqetësim të shfaqur bujshëm në shoqërinë tonë, nga çdo pozicion që jemi, nga çdo rol që luajmë në shoqëri. Madje situata është e ngarkuar me doza të forta neglizhimi biheviolist dhe indiferentizmi etik.

Kjo po krijon kushte të vështira, që nuk e bën të lehtë aksionin social edukativ apo angazhimin tonë qytetërues për t’u marrë me këtë çështje të madhe të jetës sociale, që ka të bëjë me rregullimin e problemeve edukative të shoqërisë shqiptare si “tërësi sociale”, të sjelljes individuale të qytetarëve tanë. Sepse ne në këtë betejë etike kemi një “disfavor historik”, ngaqë nuk jemi mësuar, as nuk kemi përvojën e edukimit të njeriut në liri. Por nuk kemi të zhvilluar as instrumentet e vetedukimit si proces i natyrshëm i qytetërimit, si veprimtari sistematike dhe e vetvetishme e formimit të qytetarit me normat dhe vlerat e përbashkëta të shoqërisë moderne.

Ndaj duhet të mendojmë që për të pasur shoqërisht suksesin e merituar, për të ecur në “rrugën e duhur”, na duhet së pari si shoqëri të bëjmë një “revolucion konceptual” social dhe individual, edukativ dhe mendor, në mënyrë që të ndryshojmë së pari mënyrën e të menduarit për sjelljen e qytetëruar dhe pastaj për vetë sjelljen konkrete të njerëzve, që janë kusht për të larguar shoqërinë dhe veçanërisht organizimet dhe agjencitë sociale dhe posaçërisht institucionet specifike të edukimit për t’i larguar ato së

pari nga bindjet e vjetra edukative që nuk kanë më shans të japin rezultat në kohën tonë. Nuk na lejohet të hallakatemi kot dhe ca më tepër të vonohemi për të ecur në rrugën e duhur. “Revolucioni edukativ” mund të realizohet së pari duke kapërcyer me çdo kusht besimet arkaike, bindjet hipersociale të së kaluarës, mentalitetet për fuqinë e ndikimit masiv edukativ të shoqërisë mbi njeriun.

Koha që po jetojmë na ka vënë përballë shumë dilemave sociale, personale dhe edukative, të cilat mjaftojnë për të na bindur që të kuptojmë se po jetojmë “kohë të vështira” socio-edukative. Çdo ditë e më shumë po përballemi me shfaqje, dukuri, sjellje dhe fenomene sociale që jo vetëm janë shqetësues në vetvete, por janë në të njëjtën kohë “tregues sintetikë” të situatës së anomisë dhe çorganizimit social që tani zhvillohet lirisht në shoqërinë shqiptare. Si kurrë më parë janë shtuar shqetësimet sociale dhe kaotizmi edukativ, sjelljet brutale dhe qëndrimet asociale të njerëzve, është dobësuar në të njëjtën kohë edhe “kontrolli social” i shoqërisë, por edhe “vetëpërmbajtja edukative” e njeriut.

Esenca e kësaj situatë është e lidhur organikisht dhe në mënyrë të natyrshme me raportet e reja të ndryshuara që njerëzit i kanë ndërtuar me shoqërinë tonë. Shumë problematike po shfaqen marrëdhëniet e deformatuara, që burojnë nga shkelja e logjikës sociale të raporteve demokratike midis lirisë së individit dhe përgjegjësisë sociale që duhet të ketë njeriu për sjelljen e tij individuale. Këtë problem të madh social nuk po e bëjmë dot ende problem të diskutimit sociologjik dhe praktik.

Kjo ngaqë tradicionalist e kemi parë si “çështje me vete”, si problem me natyrë edukative dhe morale, duke e vlerësuar më shumë si problem dhe cilësi të jashtme të formës së sjelljes së njeriut. Ndoshta për shkak të ndikimeve të forta që ka pasur

në shoqërinë shqiptare pedagogjia formale, apo për arsye të besimit të tepruar për vlerësimin e ndikimit social edukativ të shoqërisë, çështjet e sjelljes ende nuk i shikojmë aq sa duhet si çështje ontologjike të lidhura ngushtë, thelbësisht dhe në mënyrë të pazgjdhshme me thelbin e ndryshuar të njeriut modern, me ontologjinë dhe kuintesencën e personalitetit të tij.

Në kushtet e një shoqërie të lirë, në kohën e reduktimit të përshpejtuar të ndikimit edukativ të formave tradicionale sociale mbi natyrën e njeriut, jemi të detyruar që, për të pasur sukses në operacionin e përbashkët social, për të “rregulluar shoqërinë”, për të përmirësuar “standardet e edukimit” dhe ndërtimin e “strukturës së re të sjelljes” qytetare të njerëzve tanë, së pari ato duhen parë më ndryshe. Sepse te njeriu i sotëm me natyrë personale dhe sociale të kontradiktore dhe të ndërlikuar, nuk mund të ndikohet me standardet, format dhe modulet e vjetra të edukimit dhe punës edukative, sepse duhet llogaritur që vetëm koha dhe “tereni edukativ” ka ndryshuar, por është “transformuar” dhe thelbi i natyrës së njeriut modern me të cilin bashkëjetojmë. Ato nuk janë më siç kanë qenë më parë. Kjo do të thotë që kur planifikojmë të edukojmë ose të përfshihemi në role edukatori dhe të bëjmë punë edukative në familje, në shkollë, në komunitet apo në institucione fetare duhet të llogaritim të vërtetën e ndryshuar, se në thelbin e sjelljes, në esencën dhe format e sjelljes edukative njerëzit po shfaqen gjithnjë e më pak qenie sociale apo njerëz të qytetëruar me “dimension edukativ”.

Kjo dukuri nuk është vetëm e jona, por një problem global për njerëzimin aktual. Ndoshta kjo është arsyeja pse filozofët, sociologët, psikologët dhe pedagogët e kohës sonë flasin për një “shikim më ndryshe” të raportit të njeriut me shoqërinë dhe

me ndërgjegjen individuale, duke e parë si kusht fundamental për të pasur të garantuar koherencën edukative, unitetin e përbashkët të qenies dhe garantimin e strukturës kompakte të sjelljes personale si qytetar. Ndërtimi i strukturës së sjelljes së njeriut, situata e shfaqjes masive të njeriut pa “dimension edukativ” nuk është më aq shumë një proces social fatalisht i determinuar, apo një realitet që i imponohet atij tërësisht dhe mekanikisht nga jashtë, nga ndikimet dhe fuqia omnipotente e faktorit social.

Tani struktura dhe shfaqja e sjelljeve të njerëzve tanë në shoqëri është më shumë “çështje e brendshme” e formimit të personalitetit të tij, që ka të bëjë me mënyrën sesi i vendos njeriu raportet personale me ndërgjegjen e tij dhe të tjerët, nga forma që ai përdor për të ndërtuar “strukturën e sjelljes”, si sendërton formën e dukjes së individualitetit të tij të veçantë, si kompozon subjektivisht “inividiumin e papërsëritshëm”.

Me fjalë të tjera, kjo strukturë e ndërlikuar e sjelljes së njeriut nuk është dhe nuk duhet parë si një pasqyrim mekanik i dëshirave dhe parimeve morale të shoqërisë, por si produkt autentik, i veçantë, i përveçëm, që në një masë të konsiderueshme nuk është i lidhur shumë me “determinimet e jashtme” të shoqërisë sesa me “Odisenë e shpirtit” të njeriut konkret, me dëshirat dhe aftësinë e tij për të ndërtuar një “strukture personale” sjelljeje, e cila në çdo rast është në “lidhje sociale”, me raportet që vendos në radhë të parë midis “vetes” dhe “ndërgjegjes” së tij.

Ky raport edukativ i ndërtuar në mënyrë subjektive, është më shumë proces intim sepse njeriu i lirë duke qenë pa dimension të determinuar social dhe edukativ, është Sovran

në mënyrën si i ndërton raportet vetjake të sjelljes sociale, në përputhje me nivelin dhe ndërgjegjen e tij. Duhet të kuptojmë, të pranojmë dhe të përshtatemi me të vërtetën se njerëzit tanë tani dhe kurrë më pas, nuk shfaqen si “turma” të determinuara, me sjellje sociale të përbashkëta dhe të imponuara, por si njerëz të lirë, me “strukturë autentike” sjelljeje, me mënyra të veçanta të realizimit të sjelljes qytetare.

Ndryshime postmoderne për lidhjen e individit me familjen

Në shoqërinë shqiptare për shkak të situatave sociale kaotike dhe ndikimeve turbulente të përhapjes së zgjeruar të liberalizmit dhe thellimit të mënyrës individualiste të jetës, e cila është bërë pa dyshim “ideologji e postmodernitetit”, është krijuar një kaos konceptual për të kuptuar dhe për të interpretuar drejt raportet e krijuara midis familjes si institucion bazë i jetës private dhe strukturës themelore e organizimit të jetës shoqërore.

Pa dyshim, të gjitha organizimet e jetës me natyrë sociale janë duke kaluar krizat e ndikimit të mënyrës individualiste të jetës, për pasojë fenomenet e shfaqura me natyrë asociale kanë ndikuar në procesit e rivlerësimit të vlerës së këtyre institucioneve të organizimit social. Në radhë të parë të raporteve të njeriut si individ me familjen si strukturë.

Në fakt duke vlerësuar në mënyrë sintetike situatën, në mënyrë të qartë shihet se në çështjen e rivlerësimit të raporteve të familjes dhe rolit të njeriut si individ, duket se kanë marrë shumë përparësi idetë, që mbivlerësojnë

raportet e reja të individit me familjen, duke i parë zhvillimet dhe duke i vlerësuar dukuritë nga pozitat liberale e ultrapersonaliste.

Kjo ka bërë që në shoqërinë tonë të pranojmë së pari realitetet dhe të përballemi me efektet sociale të ndryshimit të këtij ekuacioni bazal të jetës sociale, që lidhet me ridimensionimin dhe ndryshimin e raporteve dhe përparësive të vjetra midis individit si njeri dhe familjes së tij si strukturë e jetës sociale. Është e vërtetë dhe ka shumë fakte sociale, arsye e faktorë materialë që tregojnë se në kohën postmoderne është plotësisht e natyrshme që të ndryshojnë raportet klasike dhe marrëdhëniet midis familjes dhe individit.

Nëse në familjen tradicionale shqiptare institucioni i familjes ishte me peshë të veçantë sociale dhe individ i ishte pjesë përbërëse, i detyruar për të respektuar disiplinën sociale dhe normat kulturore dhe edukative të saj, sot duket sikur ky rol thelbësor i familjes shqiptare është tronditur, substrati i vjetër holistik është dobësuar pikërisht për shkak të idesë postmoderne, të përhapur tashmë edhe në shoqërinë shqiptare, sipas së cilës në jetën e sotme rëndësi më shumë ka individ i identitet dhe entitet më vete në raport me konvencionalitetet sociale të imponuara prej funksioneve dhe strukturës holistike të familjes tradicionale shqiptare.

Në këtë klimë skepticizmi për familjen dhe për rolin e saj duhet riparë dhe rivlerësuar sfondi social dhe konteksti kulturor i marrëdhënieve të reja të njeriut si individ me familjen si strukturë, sepse me sa duket në mënyrë të sigurt jemi në kushtet e shoqërisë postmoderne, dhe për pasojë përballë realitetit të rritjes dhe të zhvillimit të dukurive e fenomeneve kontroversale. Në një masë të konsiderueshme

ato janë me natyrë pozitive, dhe me ndikim të fortë progresiv në aspektin e emancipimit të individit si njeri në raport me determinimet e familjes si strukturë sociale. Por nga ana tjetër dhe në të njëjtën kohë kjo tendencë e pakontrolluar, anarkike dhe sipas treguesve të sigurt, e dalë nga shinat e normalitetit social është bërë faktor degradues për rolin, funksionet sociale dhe edukative të familjes shqiptare.

Kjo situatë e lidhjeve, marrëdhënieve dhe kontradiktave midis familjes dhe individit, duhet parë dhe vlerësuar me kujdes, pa synuar që të tentojmë të rikthejmë familjen autoritariste tradicionale me role dhe funksione të tepërta sociale, pa e pranuar idenë e asaj tipologjie të familjes, që më shumë ka shërbyer si “çerdhe despotizmi”, por në të njëjtën kohë duke vlerësuar edhe anomalitë e situatës së sotme dhe duke u përballur me valët e shturjes sociale të destruktivitetit konceptual të cilat po përplasen fort dhe pa pushim mbi familjen dhe që kanë filluar në mënyrë të frikshme të dobësojnë vlerën dhe autoritetin e saj social si strukturë bazë e jetës që duhet të ekzistojë dhe të funksionojë edhe në shoqërinë postmoderne.

Në këtë revan kundër familjes dhe rolit të saj në raport me individin, pa dyshim që një ndikim të madh kanë qëndrimet e njëanshme, nihiliste dhe krejtësisht mohuese ndaj vlerave të familjes tradicionale shqiptare. Në të vërtetë ajo familje ka shumë të meta që duhen mohuar në esencë sepse nuk mund të mohohet natyra shumë e vjetër dhe lidhjet me natyrë konservatore në raport me liritë dhe të drejtat e individit brenda saj. Por nga ana tjetër mund dhe duhet të rishikojmë dhe të vlerësojmë edhe disa nga vlerat e pamohueshme të familjes tradicionale.

Sepse jemi në momentet kur ultraliberalët dhe ideatorët e eksentrizmit individualist dhe ata që janë kundër qendërimit

familjar të individit, e kanë drejtuar sulmin total në tërësi kundër familjes tradicionale shqiptare. Jo aq shumë në teori, sepse akoma nuk kemi ide aq të sofistikuar që të maskojnë me elegancë teorike thelbin e këtij sulmi antisocial dhe kundërfamiljar, por përmes sjelljeve dhe veprimeve që në fakt kanë spostuar radikalisht rolin social të familjes shqiptare dhe që për pasojë kanë ndikuar negativisht dhe kanë holluar “stofin” e saj të trashëguar kulturor dhe edukativ.

Natyrisht, në mënyrë të sigurt duhet pranuar se familja tradicionale shqiptare nuk ka qenë e përkryer në funksionet e saj dhe sidomos në lidhjet dhe marrëdhëniet me individin, për shkak të mungesës së hapësirës demokratike të marrëdhënieve, mungesës së demokratizimit të tyre. Ajo familje ka qenë përgjithësisht autoritariste, maskiliste dhe gerontokratike. Këto të meta, që janë thelbësore, duhen njohur dhe pranuar për hir të së vërtetës dhe si mjet për të seleksionuar prej saj atë që është racionale dhe që mund t’i shërbejë realiteteve të familjes së kohës postmoderne.

Por nga ana tjetër nuk mund të jesh dakord me ringjalljen e një nostalgjie totale e pa kushte për këtë lloj familje totalitariste, antidemokratike, kundërliberale që sundonte mbi individin dhe pjesëtarët e familjes përmes mbajtjes gjallë vetëm të autoritetit familjar vertikal mbi individët e saj. Sidomos mbi gratë dhe fëmijët. Madje ka qenë me shumë probleme e të meta, të cilat të para me optikën e sotme të liberalizmit, individualizmit dhe nevojës së demokratizimit të saj, nuk mund të mohohen.

Idolatrizimi i modelit tradicional të familjes shqiptare në kohën tonë është teorikisht konservatorizëm dhe praktikisht një pengesë reaksionare për zhvillimin e mëtejshëm të saj sipas parametrave të qytetërimit postmodern. Por, pa

mohuar të metat thelbësore dhe sidomos ambalazhet e saj supermoralizuese, ne duhet të shikojmë atë që është racionale dhe që duhet ta trashëgojmë nga familja tradicionale, aq sa vlen dhe në ato përmasa që na duhet, i shërben kohës dhe ruajtjes së shëndetit të familjes së sotme nga patologjitë dhe lajthitjet skizofrenike të koncepteve të familjes së hapur, të shthurur, pa strukturë të qëndrueshme dhe pa disiplinë sociale. Sado të liberalizohet nga brenda familja shqiptare, sado të pavarur të tentojnë të bëhen individët prej saj, ajo ka nevojë të ketë Kushtetutën e saj e cila duhet të jetë bazë për ndërtimin e lidhjeve dhe marrëdhënieve.

Ndryshimet, që kanë ndodhur brenda familjes shqiptare, janë të lidhura edhe me atë që ka ndodhur jashtë saj ose në marrëdhëniet e saj me faktorët e jashtëm. Nuk duhet neglizhuar fakti që në të kaluarën lidhjet e familjes tradicionale me shtetin kanë qenë shumë të forta, madje tejet deterministe. Madje, pa asnjë dyshim, shteti ishte faktor me rëndësi, sepse jo vetëm që ishte i pranishëm dhe ndikues brenda familjes, por dhe ndërhynte në mënyrë drejtpërdrejtë dhe tërthore në punët e saj. Ndërsa sot zhvillimet politike dhe transformimet e thella sociale, kulturore e morale kanë krijuar kushtet që jo vetëm shteti nuk është më faktor brenda familjes, por dhe familja si strukturë sociale është tërësisht jashtë dhe pothuaj e pavarur nga shteti, nga punët dhe rolet e tij.

Në këto kushte janë shtuar shqetësimet sociale të individit për familjen, paqartësitë për rolin e ri të saj në kushtet e postmodernitetit. Në mënyrë të dukshme situata e sotme e raporteve të individit me familjen e tij është ndërlikuar ngaqë momentalisht ka një varg problemesh konceptuale dhe empirike që kanë dalë përballë si sfida për familjen shqiptare

dhe duan përgjigjen e duhur. Në mënyrë të përmbledhur mund të sintetizohen përmes këtyre pyetjeve:

Cilat funksione sociale do t'i mbeten familjes, si do të jenë lidhjet biologjike dhe përgjegjësitë morale, sociale dhe relacionet ekonomike të individëve brenda saj? Çfarë strukture kompozicionale dhe ç'lidhje sociale do të ketë midis brezave, sa e madhe do të jetë dhe si do të ecë procesi modern i ristrukturimit të saj, si do të evoluojë përgjegjësia sociale e familjes në raport me fëmijët, me të moshuarit dhe me personat me aftësi të kufizuara? Çfarë do të mbetet private dhe çfarë do të vazhdojë të bëhet publike nga relacionet dhe prerogativa si ekskluzivitete të saj? Sa kënaqësi do të vazhdojë të japë familja për anëtarët e saj? Ku po shkon ajo sot, dhe cila do të jetë e ardhmja e saj nesër?

Në shoqërinë tonë, këtij proces shpesh shtypi, politika, media dhe opinioni publik i vendos etiketime të nxituara emocionale duke u udhëhequr nga standarde e paragjytime të vjetra konservatore, që nuk kuptojnë dhe nuk pranojnë ndryshimin e tipologjisë së familjes shqiptare ose nga qëndrime moderniste dhe ekzibicioniste të disa të tjerëve, që të udhëhequr nga epidemia e modës liberale të familjes së lirë dhe me sa më pak detyra dhe funksione të kondicionuara, mbivlerësojnë edhe dukuritë e reja, të cilat në thelb nuk ndihmojnë për qëndresën humaniste të saj, si institucioni i parë i shoqërisë njerëzore.

Familja moderne shqiptare është në momente të vështira kur, në mënyrë të qartë ajo shfaq dukuri dhe ka shumë probleme të diskutueshme, që janë me natyrë organike, duke filluar nga problemet e konceptimit dhe ndërtimit deri te motivet dhe qëllimet e ekzistencës së saj. Me gjithë diskutimet e shumta,

askush nuk ka guxuar të mohojë vlerën themelore dhe epërsinë ekzistenciale të saj. Funkcionin human dhe thelbin e relacioneve që familja mund të sigurojë midis pjesëtarëve të saj.

Në ndryshimet e raporteve të individit me familjen në kohën e sotme ka shumë faktorë që ndikojnë në mënyrë kontroversale. Në këto kushte çështja duhet të diskutohet në dy plane. Së pari, duke vlerësuar nga pikëpamja psikologjike abstrakte, vlera e familjes, sipas psikologëve dhe moralistëve rritet, ndërsa duke e gjykuar nga pikëpamja e vjetër si strukturë me vlerë ekonomike, roli i saj vjen duke u zvogëluar. Megjithatë edhe duke u nisur nga këto këndshikime, studiuesit e familjes shikojnë si funksion kryesor të saj, pikërisht aftësinë e saj unike për të “përshtatur individin” me jetën dhe sfidat e saj.

Pavarësisht prirjes liberale dhe thellimit të natyrës individualiste të jetës në Shqipëri, me siguri që familja do mbetet si një grup i vogël i organizimit të jetës intime e private të individit. Në këtë kontekst ajo duhet vlerësuar me kujdes dhe duhet mbrojtur me çdo kusht nga “valët shthurëse” dhe ekzibicionet e individëve anormalë sepse është ndoshta e vetmja bërthamë sociale që i jep kënaqësi individit, duke i siguruar atij relacionet psikologjike dhe humane të sigurimit, mbrojtjes, njohjes së identitetit të cilat krijohen vetëm brenda saj. Natyrisht pa mohuar në të njëjtën kohë trendet e zhvillimeve postmoderne të familjes të cilat kanë në themel të tyre tendencat dhe prirjet evolucioniste të familjes.

Ka kohë që studiues të ndryshëm, duke parë zhvillimet e sotme të familjes në nivel global, janë të mendimit se familja si institucion dhe mënyrë e organizimit të saj, janë të lidhura me drejtimit e zhvillimit të jetës postmoderne. Kjo do të thotë se duhet të mësohemi me të vërtetën sipas të cilës, sa më moderne

dhe bashkëkohore të bëhet shoqëria jonë, aq më shumë do të reduktohen në mënyrë të natyrshme disa funksione të saj. Por e sigurt është se ajo megjithatë do të mbetet si bazë e lidhjeve më të ngushta njerëzore. Edhe pse nga pikëpamja sociale familja mund të bëhet me më shumë “lidhje simbolike”, me strukturë organizimi më të lehtë, me lidhje ekonomike gjithnjë më të vogla. Në këtë sfond zhvillimesh do të ecin edhe lidhjet, po edhe marrëdhëniet individuale të njerëzve tanë me familjet e tyre. Sot dhe në të ardhmen...

Kundër paternalizmit që i zë frymën lirisë së individit

Nuk është krejt i befasishtëm dhe i paparashikuar fakti që periudha e tranzicionit politik, social dhe ekonomik në shoqërinë tonë do të ishte fare i qetë, proces i “kadifejtë” dhe pa pasoja të gjera sociale. Vetëm naivët mund të besojnë se ndërrimi i sistemit do të ishte një akt i thjeshtë mekanik apo një ndërrim automatik i këmishës së vjetër sociale totalitariste me atë demokratike. Koha po vërteton të kundërtën. Nuk është gjë e lehtë të kalosh nga një shoqëri e mësuar dhe e përshtatur me njeriun, që jetoi për gjysmë shekulli në turmë, i nënshtuar totalisht e kudo në jetën politike, veprimtarinë ekonomike, në jetën në familje, në shkollë, në shoqëri nga të gjitha llojet e paternalizmave në një shoqëri postmoderne, e cila sfidon paternalizmin si ideologji e totalitarizmit me mentalitetin social të dëshirës së njeriut për sovranitet social, të bazuar në konceptin kundër paternalist të sjelljes së përveçme.

Revolucioni, që ka ndodhur në sferën e jetës sociale në shoqërinë tonë, mund të karakterizohet si periudhë e kalimit të